

# TROPOJA

**“ERA E NDRYSHIMIT QE PERKUND TE ARDHMEN E  
NDRITUR TE KETIJ VENDI”**

**REVISTA PROMOVUESE E BASHKISE**



NR.1


DHJETOR 2020



## TROPOJA

**“ERA E NDRYSHIMIT QE PERKUND TE ARDHMEN E  
NDRITUR TE KETIJ VENDI”**

**REVISTA PROMOVUESE E BASHKISE**



**BASHKIA TROPOJE**

**NR.1**

**DHJETOR 2020**

## **BASHKIA TROPOJË**

Sheshi "Azem Hajdari"  
Kodi postar 8701  
Bajram Curri, Tropojë, Shqipëri

**E-MAIL:**  
[info@tropoje.gov.al](mailto:info@tropoje.gov.al)

**ADRESA ELEKTRONIKE:**  
<https://tropoje.gov.al/>

**FACEBOOK:**

Bashkia e Tropojës


**WEB:**  
[www.bashkiatropoje.gov.al](http://www.bashkiatropoje.gov.al)

**SHTYPI:** Dukagjini, Pejë

## **INTERVISTE**

### **RRUGA JETESORE I NJE NJERIU QE KA SHEJTN PUNEN ...**

-Intervistë me kryetarin e Bashkisë



Tropojë **REXHE BYBERAJ** –

Lindur dhe rritur në Margegaj, në një familje me tradita, ai ja ka dalë të ëndërrojë guximshëm dhe të bëjë realitet atë që pakkush kishte pritur, apo kishte menduar...

Të jetë kryekomunari më jetëgjatë dhe më i suksesshëm i Tropojës, duke udhëhequr me karizëm Komunën Margegaj, për katër mandate me rradhë, përmes një rruge vërtet të mundimshme, gjatë të cilës ka sendërtuar një model të veçantë të

qeverisjes vendore, por dhe një model të vetvetes.

Nga një njeri i zakonshëm i provincës, që dikur merrej me diçka krejt tjetër, tek një jurist që tani drejton bashkinë e Tropojës dhe ka dinjitetin të udhëheqë me projekte të qarta të ardhmen e ndritur të këtij vendi. Duke qënë vazhdimisht në ndërveprim aktiv me njerëz të thjeshtë, deputetë, ministra, ambasadorë, por edhe me kryeministrin, me të vetmin qëllim, ndryshimin pozitiv dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve të Tropojës.

Të cilët i nderon dhe ju kërkon të punojnë të gjithë, duke kontribuar sadopak në përmirësimin e ekonomisë, të imazhit social dhe turistiko kulturor të Tropojës, por kryesisht të Luginës së Valbonës, perlës turistike të Alpeve shqiptare. Një njeri që beson fort tek intelektualët, tek kultura dhe misioni i saj si dhe tek forca e madhe e atdhedashurisë dhe bashkimit të shqiptarëve, përmes njohjes dhe promovimit të vlerave atdhetare dhe patriotike, etnografike dhe historike, minerare dhe turistike...

Një njeri me identitet të fortë politik, me qasje dhe ambicie të spikatur dhe me angazhim të pandalshëm kah zhvillimet e ditës, duke u përpjekur vazhdimisht të jetë në qëndër të tyre, si objekt dhe subjekt, ndërmjet pajtimesh dhe kontestimesh të

dendura, të cilat padyshim e kanë kalitur në profilin e një politikani që tashmë synon të shkojë përtëj të arriturave aktuale personale...

Ai pranoi me kënaqësi të jape këtë intervistë, pavarësisht se i ka ndodhur të japë shumë të tilla dhe të jetë shpeshherë pjesë e kronikave dhe dokumentarëve televizive në kanale të njoitura brenda dhe jashtë vendit. Një intevistë ndryshe, përtëj kryetarit të një bashkie, më tepër për formimin dhe botën e tij shpirtërore dhe pengjet e ditës:

**PYETJE:** Jeni ulur në karrigen e kryetarit të Komunës Margegaj në mos gaboj në vitin 2000, kur Tropoja po dilte ngadalë nga mjegulla e frikshme dhe një rrëth vicioz i kaosit dhe i pasigurisë. Në fakt ishte rastësi, nxitje nga individë apo forca të caktuara, apo vertet besuat se i kishit kapacitetet dhe dëshirën për ndryshim?

**PERGJIGJE:** Duke ju referuar pyetjes provokuese që ju me bëni, po citoj një shprehje të Henri Kissinger i cili thotë : “Në demokraci biem dakort për të mos rënë dakort!” Me këtë dua të tregoj se në korsinë e politikës vendosa të hyj sepse gjatë asaj kohe Kosova ishte në luftë dhe ne si pjesë e Malsisë së Gjakovës i ndihmuam me strehim, kur secila familje në Tropojë kishte në shtëpinë e vet nga

një familje, apo disa të tilla, me shumë anëtarë..

Por duhet të theksoj se për clirimin e Kosovës shumë tropojanë dhanë jetën në emër të lirisë së Kosovës. Nuk më mungonte vetëbesimi tek vetja, pasi jam pjesë e një familje të madhe që ka dhënë kontribut për Tropojën me figura historike si Hazhi Zek Byberi, i cili harxhoi pasurinë e tij për të varfërit dhe për mbrojtjen e trojeve shqiptare nga pushtuesit e huaj , po ashtu Elez Byberi një gazetar profesionit dhe ambasador i Tropojës në SHBA...

Që nga dita që mora mandatin kisha si parim..” Jam shërbëtor i komunitetit dhe stafin e punës do ta përzgjedh më të kualifikuar se veten, duke mos marrë në konsideratë bindjet politke të cilave ju përkasin, por aftësitë e tyre profesionale.

**PYETJE:** Në mënyrë të përbledhur, a do të mund të listonit arritjet tuaja për të cilat ndiheni krenar në keto katër mandate të qeverisjes tuaj vendore dhe pamundësitë në realizimin e projekteve tuaja të synuara? Apo më mirë, cilat janë projektet që ju keni realizuar gjatë këtyre 4-mandateve si Kryetar Komune që kanë sjelle përfitime për 10 fshatrat në përgjithësi, por edhe për çdo banorë? A ka projekte që nuk janë venë në zbatim?

**PERGJIGJE:** Investimet që janë realizuar gjatë viteve që unë

administrova këtë Komunë janë shumë, por po citoj ato më kryesoret për banorët, ndërtimin e shkollave 9-vjeçare në disa fshatra, infrastrukturën automobilstike me sinjalistike- ndricim, ngritjen e disa qendrave shendetësore në fshatrat që nuk kishin, po ashtu ndërtimin e ujësjelles-kanalizimeve në të 10 fshatrat e Komunës. Projektet që nuk janë realizuar tashmë po finalizohen nga drejtues të tjerë, pjesë e stafit tim të mëparshëm, njerëz ambiciozë, punëtorë dhe idealistë.

**PYETJE:** Kush është në të vertetë qytetari Rexh Byberaj, cila është rruga juaj jetësore që nga fëminia e largët deri tek pjekuria si lider i një komuniteti të madh dhe i një zone të përmendur të Tropojës? Si do të argumentonit ju nese fjalinë e parë të biografisë tuaj do ta fillloja me këtë fjali...” isha, jam dhe do të jem shërbëtor për këtë komunitet”?

**PERGJIGJE:** Në fakt kështu fillon autobiografia ime, pasi gjatë viteve që kam punuar në SMT dhe duke qenë se isha i përndjekur politik, nuk kisha mundësinë e shkollimit, por sa herë flas për shkollën më kujtohet një shprehje e Makjavelit që thotë:” Nuk ka rendësi sesi e merr pushtetin, por sa e mban atë...”

Ndaj misioni im në këtë lloj profesioni është se “ Para se të ushqej fëmijët e mi mendoj të ushqej edhe fëmijët e secilit banor të këtij vendi...”

**PYETJE:** Ju jeni mik i artistëve dhe shkrimtarëve, mik dhe mbështetës i palëkundshëm dhe i kudogjendur i veteranëve të luftës dhe të punës, shok modest i hallexhinjëve dhe të varfërve. Kjo është pjesë gjenetike e karakterit tuaj, nuhatje prej politikani apo fryma adekuate e pervojës sintetizuar në sjelljen tuaj prej pushtetari të suksesshëm? Si e ndjeni me shumë ju veten?!

**PERGJIGJE:** Mik i secilës klasë, pasi në fushën e kulturës kam miq si Besnik Mustafaj, Petrit Malaj, Azgan Haklaj, Dhori Kule, etj, në politike...kujtoj të ndjerin Azem Hajdari, deputete, ministra dhe ish-ministra të kësaj Qeverie dhe asaj që ishte...i veteranëve, por të qenit mik me të varfërit për mua është privilegji, pasi ky është edhe problem që unë kam vendosur që përmes projekteve të rris mirëqenien ekonomike, shendetësore dhe arsimore të kësaj kategorie.

**PYETJE:** Duke qënë i vjetër në përvojat dhe kalvarin jetësor, por i ri dhe energjik në moshë dhe mëndësi, cili mund dhe duhet të jetë caku juaj i ardhshëm i karrierës dhe kontributit jetësor për Tropojën dhe zhvillimin e saj?

**PERGJIGJE:** Nuk kam një etalon matës, karriera për mua është vetem punë, por në varësi të problemeve që kanë banorët dhe aftësitë e mia menaxheriale varet edhe

niveli i ngjitjes së shkallëve për në hierarkinë politike.

**PYETJE:** Si mendoni, çfarë është të jesh një njeri i suksesshëm dhe i respektuar në Tropojë dhe jo vetëm, një mundim, një detyrim, një fikcion apo një rrugë e natyrshme jetësore që duhet plotësuar dita ditës?

**PERGJIGJE:** Politika është arti marrjes se pushtetit i cili përfshin mundim nëpërmes punës, detyrim ndaj besimit të secilit banorë që më ka votuar dhe gjithashtu një rrugë e gjatë jetësorë të cilën mundohesh që ta plotësosh sipas qëllimeve që i vendos vetes.

**PYETJE:** Nisur nga ky parim i juaji, a mund të përmblidhni sagën e vështirë të drejtimit të Bashkisë Tropojë, në këtë vit të parë të qeverisjes, sfidat me të cilat jeni përbashkët dëshmojës, që ju kanë veçuar si njëri nga kryebashkiakët më të suksesha të vendit.

**PERGJIGJE:** Duke e konsideruar pushtetin si një mundësi për tu shprehur ndryshe dhe për të përfaqësuar mundimin e pazakontë të komunitetit tropojan ndaj deformimit të dukshëm dhe të pështirë të

vullnetit të tij nga paraardhësit e mi politikë, sfidova momentin historik dhe kur pritej ndryshimi u vura në ballë të protestës ndaj këtij deformimi dhe shpresova në mekanizmin e zgjedhjeve. I bindur se do të duhej një qasje tjetër jo vetëm politike, por edhe praktike, për ta sjellë sa më afér publikut sherbimin, por dhe të mirat që sjell mirëadministrimi i pushtetit.

Vertet kam pasur një kapërcim të madh politik, por përtej çdo interpretimi, duke e pasur shejtni punën dhe vetëm punën zgjodha kahun progresiv dhe angazhimini tim ndaj zhvillimit të Tropojës si qellimin kryesor të jetës time në vazhdim.

Dhe besoj se ky vit dëshmoi se unë dhe stafi im kemi pasur të drejtë, veprat dhe investimet konkrete tregojnë se jemi në udhën e duhur dhe do të vazhdojmë me ngulm drejt realizimit të objektivave, sipas projekteve madhore dhe mbështetjes së pakursyer nga ana e qeverisë dhe veçanërisht të kryeministrat, i cili ktheu vëmendjen dhe këmbënguljen për të investuar për të ardhmen e ketij vendi dhe të banorëve të tij.

Ju faleminderit!

**Tropojë, Nëntor 2020**

**PUNA DHE SHERBIMET PUBLIKE TE VITIT**

**RELACION MBI AKTIVITETIN E SEKTORIT TE TATIM TAKSAVE PER  
10/MUJORIN E VITIT 2020**

**NGA: NUREDIN AHMETAJ**

**HALIM SELIVRADA**

Realizimi i të ardhurave tatimore si 10/mujor është në masën 80.9%, ose nga 47.2 milion lekë plani, realizuar 38.2 milion lekë.Ndikimi kryesor në punën e këtij sektori është situata e ngarkuar nga Pandemia e Covid-it, por gjithsesi puna ka vazhduar pandërprerje.

Grupet e punës te terrenit në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, me programe te vecante pune, kanë vazhduar lidhur me arkëtimin e borxhit tatimor, si dhe në drejtim te minimizimit te informalitetit.Po kështu nga specialistet e zyrës tatim taksave eshte realizuar përpunimi i dokumentacionit, sqarimi i tatimpaguesve , dërgimin e dokumentacionit tatim paguesve për njohjen me paketen fiskale me lehtësitet tatimore dhe faturat për arktim te detyrimeve.

Janë zhvilluar dëgjesa publike me grupet e interesit, me biznesin dhe me shoqërine civile,



lidhur me Paketën Fiscale për vitin 2021, ku nga sektori ynë është punuar me përgjegjësi në këtë drejtim.

Në kuadër të situatës së krijuar nga Pandemia COVID -19, duke parë vështirësita e krijuara nga kjo situatë bizneseve, Këshilli Bashkiak, për taksat/tarifat e vitit 2020, nga 20 Prill 2020, që ka qenë afati ligjor për pagesën e tyre, e ka shtyre afatin deri me 10

Shtator 2020 , ndërsa me lehtesi tatimore -10% zbritje te vlerës së totalit taksa/tarifë subjekteve që kanë arkëtuar deri me 30 Qershor 2020.

-Sektori i Tatim/Taksave ka hartuar plane pune periodike , sipas detyrave funksionale të secilit punonjës dhe puna vazhdon pa ndërprerë.Ndikime negative në të ardhurat tatimore kanë ndikuar, sidomos në disa zëra të ardhurash, dhe konkretisht ;

- Në të ardhurat nga taksa e fjetjes në hotel
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

- Tarifat e shërbimit nga kopshtet/cerdhet
- Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve ne pronësi te Bashkise.

Po kështu edhe në drejtim të punës së menaxhimit të borxhit, ka struktura përkatese që po realizohet ndjekja për arkëtimin e tyre dhe marrja e masave shtërnguese, konform legjisACIONIT fiskal.Puna e jonë po vazhdon me intensitet, pandërprerje.

## UJITJA SI ELEMENT THELBESOR I ZHVILLIMIT EKONOMIK

**NGA: KUJTIM BALIAJ**

**XHAVIT ÇELA**

Mbi punën e kryer nga sektori i ujitjes Bashkia Tropojë për vënjen në punë të objekteve ujitëse për vitin 2020, dhe konkretisht:

**Njesia Administrative Margegaj**

**Njesia Administrative Bujan**

**Kanali Ujites i Krasniqes:** Ka një gjatesi 12 km.Në bazë të grupit të punës ngritur me urdhër të k/bashkisë për evidentimin dhe vlerësimin e demtimeve gjatë sezonit të dimrit

është bëre vlerësimi dhe janë angazhuar punëtorët e sherbimeve për germimet dhe pastrimet në pjesën me të madhe të gjatësise së kanalit,punime te cilat janë kryer brenda afateve Ujita në këtë objekt funksionon në gjithë gjatësinë duke përfshire dy njesitë administrative Margegaj dhe Bujan.

Çdo punim eshte i evidentuar dhe matur në prezencë te



komisionit.Janë kryer pastrimet në një gjatesi 8984 ml , është siguruar në bazë të kërkesës se k/plakut (Fushë-Lumit)300 ml tub,janë siguruar dhe vendosur dërrasat për presat,është siguruar plasmasi për te vepra e marrjes dhe presat. Ky objekt është vënë në punë përvaditje me dt.18.05.2020.

**TROPOJA**  
**"ERA E NDRYSHIMIT QE PERKUND TE ARDHMEN E NDRITUR TE KETIJ VENDI"**

Me dt.26.06.2020 ka ndodhur një shembje afër veprës së marrjes si rezultat i amortizimit në një distancë 15 ml duke pezulluar ujitjen.Me marrjen e masave ky objekt është vënë në punë me dt.02.07.2020, duke kryer keto volume pune:

Mure guri 23 m<sup>3</sup>,Shtrese betoni 2.5 m<sup>3</sup>,Suvatim mure guri 18 m<sup>2</sup>,Transport materialesh(ranë 12 m<sup>3</sup>,çimento 3 ton,gurë 16 m<sup>3</sup>) Eshte zevendësuar një saraçineskë e demtuar në sifonin në mes Bashaje dhe Bllatës.Eshtë çbllokuar tubacioni kalim rruge në fshatin Dozhlan ,i bllokuar nga materiale dërrasa,gurë,plasmas dhe drunj.

**Kanali ujites i Shoshanit:**Në bazë të grupit të punës ngritur me urdhër të k/bashkisë janë bërë matjet dhe evidentuar demtimet në gjithë gjatësinë e kanalit dhe konkretisht:Eshtë ndërtuar ama(vepra e marrjes)pasi ka qenë e demtuar plotësisht (ka pase ulje te shtratit të lumit).Eshtë punuar një pjesë kanali e dëmtuar nga shembje nga sipër.Në zonën ku janë te vendosur dy tuba të brinjëzuar % 400 mm eshte kryer puna për zevendësimin me mure guri.Eshtë furnizuari me plasmas.Janë kryer pastrimet në gjithë gjatësinë e kanalit.Ky objekt është vënë në punë për vaditje me dt.11.06.2020.

**Njësia Administrative Llugaj**

**Kanali ujites i tek st.pompave:** Në bazë të grupit të punës ngritur me urdhër të k/bashkisë janë bërë matjet dhe evidentuar demtimet në gjithë gjatësinë e kanalit dhe konkretisht: Ndërtimimi dhe devijimi i amës me makineri(në shtratin e lumit).Ndërtimin e një ure për kalim makinerie dhe këmbësore me hapësirë drite 2 m,F.v. tub çeliku % 400 mm 4 ml,F.v.plasmas te vepra e marrjes.Ky objekt është vënë në punë për vaditje me dt.22.06.2020.

**Kanali ujites Vigi i Vakës-Cerrnicë:** Në bazë të grupit të punës ngritur me urdhër të k/bashkisë janë bërë matjet dhe evidentuar demtimet në gjithë gjatësinë e kanalit dhe konkretisht: Janë kryer germimet me eskavator për levizjen e tubave % 800 mm në gjithë gjatesin pasi ka patur disnivel me pjerrësinë e kanalit dhe nuk merrte sasinë e ujites.Eshtë ndërtuar një pusetë kontrolli në segmentin me tuba % 800 mm.Eshte ndërtuar një kalim rruge me dy tuba % 400 mm dhe kryer betonimi te shtëpia e Zeqir Kurmekës.

Eshte punuar tek shtepitë në Cerrnicë, betonim kanali me armaturë dhe 6 ml tub kalim rruge.Ky objekt është vënë në punë për vaditje me dt.11.06.2020.

**Kanali ujites Galeria e Rrogamit:** Në bazë të grupit të punës ngritur me urdhër të k/bashkisë janë bërë matjet dhe evidentuar demtimet në gjithë gjatësinë e kanalit dhe konkretisht: Janë kryer punime mure guri llaç-çimento.Suvatim mure guri llaç-çimento.F.v. tub i brinjezuar % 315 mm. strukturë betoni veshje kanali.Ky objekt është vënë në punë për vaditje me dt.10.06.2020.

**Njësia Administrative Tropojë**

**Kanali ujitetës i Gashit:** Në bazë të grupit të punës ngritur me urdhër të k/bashkisë janë bërë matjet dhe evidentuar demtimet në gjithë gjatësinë e kanalit dhe konkretisht: Eshtë ndërtuar ama (vepra e marrjes), janë realizuar germimet me eskavator në Drejtovë.Në presën e parë afér veprës së marrjes, e cila ka qënë e demtuar, është punuar betonim dhe mure guri.Furnizim me dërrasa për presa.Ky objekt është vënë ne punë për vaditje me dt.12.06.2020.

**Kanali ujitetës Ahmataj-Sopot:** Në bazë të grupit të punës ngritur me urdhër të k/bashkisë janë bërë matjet dhe evidentuar demtimet në gjithë gjatësinë e kanalit dhe konkretisht(ky kanal nuk ka qene ne funksion qe nga viti 2012): Eshtë ndërtuar ama e kanalit me eskavator dhe vendosur plasmas.Veshje me beton ne hyrje te kanalit 11 ml.Vendosur tuba % 500 mm 70 ml mbi bazamente betoni dhe kemisha betoni çdo 6 m.Riparim i sifonit me saldim pasi ka



qenë i çarë nga ngricat.Betonim bazamenti te puseta e demtuar.  
Janë ndërtuar dy priza te reja.U mbulua gjithë gjatesia e tubit me eskavator për arsyet e demtimit.Ky objekt është vënë në punë për vaditje me dt.10.05.2020.

#### **Kanali ujitetës Buçaj dhe Tafaj:** Në bazë të grupit

të punës ngritur me urdhër të k/bashkisë janë bërë matjet dhe evidentuar demtimet në gjithë gjatësinë e kanalit dhe konkretisht: Gërmim dheu për themel :F.v.tuba te brinjëzuar % 125 mm.Mure guri llaç- çimento.

Veshje kanali me beton.Suvatim mure guri.Ky objekt është vënë në punë për vaditje me dt.10.06.2020.

**Kanali ujitetës Kasaj-Viçidol:** Në bazë të grupit të punës ngritur me urdhër të k/bashkisë janë bërë matjet dhe evidentuar demtimet në gjithë gjatësinë e kanalit dhe konkretisht(ky kanal ka qene pothuajse jashtë funksioni): Prerja bimësh të vogla.Germim dheu kanal.Çbllokim sifoni % 500 mm. Ky objekt është vënë në pune për vaditje me dt.02.06.2020.


**Kanali ujites fshati Palç:** Në bazë të grupit të punës ngritur me urdhër të k/bashkise janë bërë matjet dhe evidentuar demtimet në gjithë gjatësinë e kanalit dhe konkretisht:F.v. tub ujsjellesi % 63 mm PN-10 atm .Ky objekt është vënë në pune për vaditje me dt.14.06.2020.

#### Njesia Administrative Bytyç

**Kanali ujites fshati Pac:** Në bazë të grupit të punës ngritur me urdhër te k/bashkisë janë bërë matjet dhe evidentuar demtimet në gjithë gjatësinë e kanalit dhe konkretisht:

F.v.tuba te brinjëzuar % 110 mm.Betonim pusete me armaturë (8x4x2).Ky objekt është vënë në pune për vaditje me dt.10.06.2020.

**Kanali ujites Kepenek:** Në bazë të grupit të punës ngritur me urdhër të k/bashkisë jane bërë matjet dhe evidentuar demtimet në gjithë gjatësinë e kanalit dhe konkretisht: Germim



pastrim kanali.F.v.tuba brinjezuar %315 mm.F.v.tuba brinjezuar %200 mm.F.v.tub metalik % 400 mm.Ky objekt është vënë në punë për vaditje me dt.12.06.2020.

#### Njësia Administrative Fierzë

**Kanali ujites i fshatit Rajë :** Në bazë të grupit të punës ngritur me urdhër të k/bashkisë janë bërë matjet dhe evidentuar demtimet në gjithë gjatësinë e kanalit dhe konkretisht: F.v.tuba ujsjellesi + rekorderi % 63 mm PN 10 atm.Puset kontrolli 1x1x1.Ky objekt është vënë në punë për vaditje me dt.10.06.2020.

Në sektorin e ujitjes aktualisht jane 4 punonjës definitivë dhe 16 punonjës

me kontratë të përkohshme.Angazhimi i gjithë sektorit për ujiten është maksimal, me detyra të përcaktuara dhe aktualisht të gjitha objektet ujite se janë në funksion për vaditje.

Ka probleme të renjes së niveleve të prurjeve në lumenj, por në saj të angazhimit të punonjësve prurjet po menazhohen duke siguruar sasinë e ujit në kanale.

## RRETH EMERGJENCAVE CIVILE DHE INVESTIMEVE RRUGORE

### NGA: SHQIPE GJYRIQI

Gjatë kësaj periudhe një vjeçare Bashkia Tropojë ka marre mbi 100 kërkesa të cilat kanë qënë të ndara në:

Tërmeti i datës 26.11.2019.

Rënje zjarri.

Prishje çatie



Tërmeti i datës 26.11.2019 ka pasur rreth 50 kërkesa për shtëpi të dëmtuara. Nga këto 95% e tyre ju është bërë verifikimi në terren, dhe paraqitur qeverisë për financim. Pritet financimi i tyre.

Ky vit ka pasur 8 (tetë) rënje zjarri në shtëpi banimi evidentimi dhe saktësimi në terren dhe paraqitur në këshill dhe janë ndihmuar nga fondi i Bashkisë.

Edhe Bashkia Tropojë si çdo vend tjetër është prekur nga pandemia Covid-19. Ajo mori masa të mënjezershme për menaxhimin e kësaj situatë.



Bashkia Tropojë ka dalë me vendime dhe urdhëra nga kryetari i Bashkisë Tropojë. Gjatë kësaj periudhe të pandemisë thirrjes së kryetarit për ndihmë i janë përgjigjur donatorë dhe biznese të ndryshme.

**TROPOJA**  
**"ERA E NDRYSHIMIT QE PERKUND TE ARDHMEN E NDRITUR TE KETIJ VENDI"**

Ilustratë teknologjike që përdoren në punime e ndryshimit të ardhmen e ndritur te ketij vendi.

Është bërë: Dizenfektim i shumë objekteve private dhe shtetërore, rrugë dhe institucione publike.



- Shpërndarje e 4000 pakos ushqimore, mjekësore, letra higjenike.
- 1850 thasë miell
- Kanë përfituar 407 të moshuar të vëtmuar.



Nga buxheti i bashkisë kemi një rritje fondi për emërgjencat civile nga 1.7 % në 4 %. Gjatë këti viti janë bërë investime në kanalet ujëtëse pothuajse në gjitha njësitë Administrative në kohë rekord, vlen të përmendim investimin e ri :

Sopot –Hasaj- Sopot: investim i cili ishte prej 7 viteve në pamundësi totale të marrjes së ujit. Sa i përket investimeve në rrugë Bashkia Tropojë ka bërë investim konkretisht në Njësinë Administrative Lekbibaj, Bytyç, etj. Rrugë që janë në punim e sipër: Salcë –Bricë

Bashkia Tropojë nuk e harroi turizmin, ajo edhe gjatë kësaj periudhe të pandemisë përçollti mesazhe jete dhe optimizmi.



Stafi i bashkisë Tropojë, ndoshta e pazakontë për kohën e krijuar mbolli: 2800- rrënje fidan bliri në aksin rrugor Tropojë – Bajram Curi , 2700 vazo lule si dhe 300 saksi me trandafila në Bajram Curri.

U arrit të bëhen:

- Hapja e sezonit turistik me datë 27 qershor 2020.
- Festa tradicionale e Bjeshkëve me datë 22 korrik 2020.



**TROPOJA**  
**"ERA E NDRYSHIMIT QE PERKUND TE ARDHMEN E NDRITUR TE KETIJ VENDI"**



o mungesha e kultura që ngritet e përpunuhet i kohëve të lashta teksa është mësimdhënës këtij çiftej albanore që varetin e tij, që përfshin edhe kulturën e vjetër e kohëve të lashta, që konservohen si një vlerë e rëndësishme e kultivuar në këtij vend. Të gjitha këto vlerë të vjetra që varetin e tij, që përfshin edhe kulturën e vjetër e kohëve të lashta, që konservohen si një vlerë e rëndësishme e kultivuar në këtij vend.



Festa e Nikaj  
Mërtur , Curraj  
Epër, 29 korrik  
2020.

Në vijim të udhëtimit promovues të destinacioneve turistike të zones,pas Valbonës e Sylbicës me datë 29 Korrik, jemi mysafirë në Sofrën bujare

e fisnike të Nikaj Merturit e pikërisht në Curraj i Epërm.  
Jo vetëm të huajt, por cilido prej nesh ngelet i mahnitur nga bashkjetesa shekullore e historisë njerëzore dhe mrekullisë natyrore të kësaj zone te pashoq.



Tingujt e Eposit të Kreshnikëve dhe vallet e Ansamblit "Dardania", do të jenë sfida e vertetë ndaj stresit ,që na ka shkaktuar pandemia si dhe sinjal i vertetë i shpresës se jetë ,normaliteti do kthehen me fuqishëm se asnjëherë. Nikaj-Merturi jo vetëm një destinacion magjik për tu vizituar, por dhe një vend i veçantë për të investuar!

## POLITIKA E ZHVILLIMIT TE BUJQESISE DHE ZHVILLIMIT RURAL

NGA: ING.MUHAMET KUÇANA

Rrethi i Tropojës bën pjesë në Qarkun e Kukësit dhe shtrihet në Rajonin Verioro-Verilindor. Bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishëm ekonomik të Bashkise Tropojë. Numri i fermave bujqesore është rritur dhe me drejtim kryesisht blegtoral, perime dhe frutikulturë (për tregun lokal).

Mbi 50/ e popullsisë së Bashkisë Tropojë banon në zonat rurale. Sipërfaqja e tokës bujqësore është 7387 Ha tokë arë, Pemtore 1773 Ha, Vreshtë 189 Ha, Kullota 21441 Ha, Pyje 43190 Ha, Tokë jobujqësore 31980 Ha, Troje 300 Ha.

Sot problem kryesor mbetet fragmetarizimi i tokës, gjë e cila krijon probleme në adoptimin e skemave të subvencioneve dhe futjes se teknikave të reja, gjë e cila kerkon domosdoshmerisht përfundimin e procesit të regjistrimit të tokës dhe krijimin e tregut te saj.

### Politika e zhvillimit:

Programi vendor i bujqësise dhe zhvillimit rural ka për qëllim mbrojtjen e tokave bujqësore nga ndertimet kaotike, saktësimin dhe regjistrimin e të drejtave të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të kategorive të tjera në hapësirën rurale.

Reabilitimin dhe investimin në infrastrukturën bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, duke nxitur dhe mbështetur kultivimin e kulturave dhe specieve tradicionale për çdo zonë, ndërthurjen e investimeve në sektorin e buqësisë me atë të karakterit turistik.

Programi i Bujqësise, Zhvillimit Rural dhe Trajimit i AMTP ka këto politika zhvillimi:

Mbështetja për përmirësimin e cilësise së jetës dhe nxitjen e shumëlojshmërisë së veprimitarive bujqësore dhe ekonomike, në zonat rurale, në nivelin e fermës dhe të ndërmarrjeve të vogla.

Mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e saj nëpërmjet projekteve që fuqizojnë përdorimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore si dhe të kategorive të resurseve të tjera.



Reabilitim i rrjetit kullues dhe vaditës ekzistues dhe zgjerimi i tyre në të gjithë territorin që mbulon Bashkia Tropojë. Mbështetja për përmirësimin e konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe të industrisë agroushqimore me masa të ndryshme investuese nëpërmjet projekteve.

Nxitja përmes financimit dhe këshillimit bujqësor të

organizatave, shoqatave dhe kooperativave të prodhuesve bujqësorë dhe ato të përpunimit e tregtimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore, të ngritura në baza vullnetare.

Në kuadër të ligjit nr.139/2015 "Për qeverisjen Vendore" Bashkia Tropojë ka perjegjësinë të punojë për kryerjen e funksioneve si administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujites dhe kullimit.

## TROPOJA

### **"ERA E NDRYSHIMIT QE PERKUND TE ARDHMEN E NDRITUR TE KETIJ VENDI"**

Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e të kategorive te tjera te resurseve.Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor dhe rural. Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për zhvillimin rural të financuar nga buxheti lokal dhe /ose me bashkëfinancim nga të tretë. Së shpejti do caktohet buxheti nga Bashkia për sektorin e Bujqësisë,zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP.

### **SHERBIMI I NDIHMES EKONOMIKE DHE POLITIKA SOCIALE**

#### **NGA: SHKURTE GJOKA**

Zyra e Shërbimit Social BashkiaTropojë perbehet nga:

- 1.Zyra e ndihmës ekonomike.
- 2.Zyra e PAK
- 3.NJMFdhe BaraziaGjinore.
- 4.Zyra e Strehimit.

Specialistët e Ndihmës Ekonomike sipas NjesiveAdministrative gjatë periudhës së pandemisë kanë evidentuar dhe hartuar listat e familjeve në nevojë,dhe në bashkëpunim me komisionin e emergjecave civile u janë shpërndarë paketa ushqimore.Shërbimi Social i Bashkisë, në bashkëpunim me Specailistët përkatës të Ministrisë së Shendetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kanë hartuar dhe miratuar planin Social 2020-2021, kjo është një risi.

Në këtë sektor, koha e pandemise nuk ka penguar punonjësit për të kryer në kohë pagesat dhe për të afruar të gjitha shërbimet ndaj qytetareve.Gjatë kësaj periudhe nga 377 familje të pastreha janë trajtuar me bonus strehimi 87 prejtyre.

Një pjesë e këtyre familjeve janë në pritje të zbatimit të programeve të ndryshme të strehimit për të perfituar banesa sociale me kosto te ulët.



NJMF dhe Barazia Gjinore për këtë periudhë ka trajtuar raste të ndryshme të të miturve dhe të grave të dhunuara.Për të miturit e neglizhuar dhe në konflikt me ligjin gjithnjë ju ka ardhur në ndihmë për interesin me të lartë të fëmijës bazuar në Ligjin 18/2017 për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Në bashkëpunim me Specialistët e PAK sipas Njësive Administrative, gjatë gjithë kohës, por kryesisht në periudhen e pandemisë, në ditën e Autizmit, u shpërndanë paketa ushqimore për këta fëmijë të diagnostikuar me spektrin e autizmit.Në bashkëpunim me mësuesit ndihmës, me anë të



grupit të krijuar në whatsapp, u bë konkurs për këta fëmijë piktura me e bukur, duke marrë parasysh shkallën e agravimit të autizmit, ku fituesi ishte nga shkolla Konferanca e Bujanit.

Po kështu në ditën e Komunitetit Rom u shpërndanë paketa ushqimore për këta fëmijë. Barazia Gjinore ju ka ardhur në ndihmë

grave me problematika të ndryshme në çdokohë në bashkëpunim me OFJ-të, që janë pjesë e MKR-së në Bashki.

MKR-ja në bashkinë Tropojë funksionon e përfaqësuar nga anatarët e GTN-së, duke bërë të mundur përmirësimin e nivelit të ndërhyrjes në çdo rast që paraqitet.

## PROJEKTI AMBICIOZ I PYJEVE DHE KULLOTAVE

**NGA: ANILA HYKAJ**

Në kuadër të Projektit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit ka vijuar punadhe është drejt finalizimit procesi i regjistrimit të pyjeve dhe kullotave bashkiakë si dhe po formalizohet masivi i gështenjës me iniciativën e Kryetarit të bashkisë, mbështetur gjithashtu dhe nga instancat shtetërore dhe Kryeministri me qëllim që kjo pasuri e rëndësishme për mjedisin, turizmin dhe ekonominë e rrëthit tone të ketë mundësi finacimi dhe ndërhyrje me projekte rivitalizimi.

Program pune për parandalimin dhemasat e marra për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri, duke bërë kordinimin e punës ndërmjet institucioneve, personel pyjor-njësi administrative-kryetar fshattrash-emergjencat civile-polici rendi-vullnetarë, për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarret, ngritjen e skuadrave vullnetare të MNZSH-së, përdorimin efektiv të burimeve njerëzore, materiale dhe financiare, informimin e publikut, kontolle operative, trajnimet e personelit, dhe sinjalizimin në kohë reale të rasteve kemi arritur të minimizojmë rastet dhe dëmet e shkaktuara nga zjarret.

Plani i masave për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga veprimtaritë e paligjshme, i hartuar pas takimeve të organizuara, nga përfaqësuesit e bashkisë, policisë së rendit, kryetarë fshattrash, drejtore shkollash, në çdo Njësi Administrative ka dhënë rezultate të larta në minimizimin e prerjeve të paligjshme në pyje, ndërhyrjeve të paligjshme në fond pyjor - kulloso, në luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabis-it, duke informuar dhe ndërhyrë në kohë reale për parandalimin e tyre.

**TROPOJA**  
**"ERA E NDRYSHIMIT QE PERKUND TE ARDHMEN E NDRITUR TE KETIJ VENDI"**



- Pyllëzimi i akseve rrugore Tropojë e Vjetër, Cërrnicë dhe Dubravë .

Me nismën e Kryetarit gjatë këtij viti janë mbjellë rrith 2800 fidanë bliri në akset rrugore. Mbjellja është bërë me kapacitetet e me personelin pyjor dhe të shërbimeve të bashkisë Tropojë.


Nga një verifikim paraprak rezulton se ky pyllëzim është në masën 70% të zënies.



Në kuadër të projektit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit ka vijuar puna dhe është drejt finalizimit procesi i regjistrimit të pyjeve dhe kullotave bashkiake si dhe po formalizohet masivi i gështenjës me iniciativën e Kryetarit të bashkisë mbështetur gjithashtu dhe nga instancat shtetërore dhe Kryeministri me qëllim që kjo pasuri e rëndësishme për mjedisin, turizmin dhe ekonominë e rrethit tone të ketë mundësi finacimi dhe ndërhyrje me projekte rivitalizimi.

## VEPRIMTARIA E SEKTORIT ZJARREFIKES GJATE VITIT 2020

NGA: FATMIR REXHAJ



Sektori zjarrëfikës gjatë këtij viti ka qënë tejet i mobilizuar për tju përgjigjur në kohë dhe me profesionalizëm çdo situate emergjente në Tropoje. Ky vit që po kalon ka qënë viti më i qetë përsa i përket zjarreve në pyje, kullota dhe objekte private dhe shtetërore, si dhe viti kur kemi mirëmenaxhuar vetëm 50 raste zjarri.



Suksesi i punës tonë vjen nga puna e mirë përgatitore që në fillimviti, kur u morën takime intensive në të gjitha njësitë administrative, me të gjithë kryetarët e fshatrave, duke dhënë orientimet e duhura dhe duke ngritur grupet vullnetare në çdo fshat, për mënyrën e përballimit të situatave emergjente dhe të fikjes së zjarrit, që në momentin e pare të shfaqjes së tij.

Megjithatë ka pasur edhe raste të vështira si ndërhyrja e zjarrfikësve në fshatin Cerrnicë, pas rënjes së zjarrit në katin e tretë të një banese, me datë 27.02.2020, po kështu me datë 03.07.2020 në fshatin Markaj, për shpëtimin e një banese të përfshirë nga flakët, por edhe ndërhyrja e zjarrfikësve në fshatin Shkëlzen, me datë 13.08.2020, në një terren mjaft të vështirë për forcat dhe mjetet tona.

Sektori jonë ka mjete akoma të vjetra, të amortizuara dhe të papërshtatshme për terrenin tonë, megjithatë me punë dhe përkushtim ja ka dalë ti mirëmbajë ato dhe ti gjendet institucioneve dhe komunitetit në çdo rast të vështirë.

### **PUNET E DPZHT-SE GJATE 2020”**

#### **PROJEKTE TE REJA**

#### **NGA: HAZIR ISUFAJ**

1- Rikonstruksion i Stadiumit të Lojrave me Dorë.

2- Rikonstruksion i Thertores në Qytet.

3- Projekti i Rrugës Kika- Qafë Pajë- Bradoshnicë.

4- Projekti i Rrugës Kerrnajë- Zhenaj.

5- Projekti i Rrugës Kerrnajë- Hoxhaj- Myhejan.

- 6- Projekt i Rrugës Shumicë.
- 7- Projekt i Rrugës Cerrnicë.
- 8- Projekt i Rrugës Demushaj- Lekurtaj.
- 9- Projekt i Rrugës “Jaho Salihi”, Lagje “Partizani”.
- 10- Projekt i Sistemimeve në Lagjen “Partizani”.
- 11- Projekt i Fasadave në Lagjen “Partizani”.
- 12- Projekt i Rrugës Markaj.
- 13- Projekt i Rrugës Salcë.
- 14- Rikonstruksioni i Ujësjellësit Dushaj të Epërm,
- 15- Projekt për Vendosjen e Matësave te Ujit, ne Qytet.
- 16- Projekt për Vendosjen e Koshave të Mbetjeve Urbane.
- 17- Rishikimi i Projekteve për rrugët, Rosujë- Selimaj, Qendër- Cerrnicë, Dezdar- T'pla, Astë- Myhejan.
- 18- Bashkëpunimi me FSHZH-në për hartimin e Projekteve të Kanalizimeve të Ujравe të Ndotura, dhe Impiantit të Pastrimit të Ujравe të Ndotura, (IPUN) në Valbonë.
- 19- Bashkëpunimi me FSHZH-në për hartimin e Projektit të Rikonstruksionit të Ujësjellësit në Valbonë.
- 20- Projekt i Ujësjellësit në Dragobi.
- 21- Projekt i KUZ në Lagje “Gjongecaj”.
- 22- Projekt i Ujësjellësit Nimnaj.
- 23- Projekt i Ujësjellesave dhe veprave te marrjes ne disa fshatra.
- 24- Bashkëpunim me EKB për projketimin, plan vendosjen dhe miratimin e ndërtimit të dy banesave me kosto të ulët në qytet.

**APLIKIME PER FONDE:**

Për 5 Objekte Arsimore, pranë USAID-it.

Rruja Çerem, Rruja Luzhë, Rruja Qafë Prushi, Rruja Myhejan, Ujësjellesi Valbonë, Ujësjellësi Dragobi, Ujësjellësi Quk Dunishës, Kolektori i Ujравe të Ndotura Qytet, Semaforët Qytet, etj në FSHZH.

**TROPOJA**  
**"ERA E NDRYSHIMIT QE PERKUND TE ARDHMEN E NDRITUR TE KETIJ VENDI"**

---

**OBJEKTE TE TENDERUARA:**

Rruga Dezdar- T'pla, Rruga Rosujë- Selimaj, Rruga Astë- Myhejan, Rruga Kerrnajë - Zhenaj, Rruga Cerrnicë, Rikonstruksioni i Stadiumit të Lojrave me Dorë, Ujësjellësi Dragobi, Rikonstruksioni i Ujësjellësit Dushaj Epër.

Në FSHZH, është tenderuar Objekti Rikonstruksion i Ujësjellesit të Valbonës, me vlerë 19 760 000 lekë, ndërtim i Impjantit të Trajimit të Ujrade të Ndotura, (ITUN), si dhe Kanalizimet e Ujrade të Ndotura në Valbonë, me vlerë: 75 240 000 lekë. Me EKB është nenshkruar kontrata për fillimin e punës në dy pallate me kosto të ulët në qytet, për njerin eshte miratuar leja e zhvillimit.

**LEJET E NDERTIMIT**

Gjatë këtij viti janë shqyrtuar 81 Aplikime të qytetarëve në sistem, për leje zhvillimi, leje ndërtimi, çertifikata përdorimi, njoftime për fillim punimesh, shtyrje afati punimesh, ndryshim funksioni, deklrata paraprake, etj. Nga këto janë miratuar 39 aplikime si ma poshte:

- 11 Leje Zhvillimi (një per pallatin me kosto të ulët nga EKB-ja)
- 12 Leje Nderimi (nga këto dy, për stadiumin dhe për thertoren qytet)
- 3 Çertifikata Përdorimi
- 9 Njoftime për fillim Punimesh
- 1 Shtyrje afati
- 1 Ndryshim Funksioni
- 1 Ndryshim Subjekti
- 1 Deklaratë paraprake

Janë në proces për t'u miratuar Lejet e Ndërtimit për Pallatin në Lagjen Partizani dhe Ndërtimin e Ujësjellësit, Kanalizimeve të UN Valbonë si dhe IPUN.

Janë të përditëshme takimet me qytetarët për problemet e ndryshme, si dhe kthim përgjigjet e rreth 500 shkresave të ardhura nga qytetarë te ndryshëm dhe institucionë.

## PERKUJTIME

### TROPOJA NDERON HISTORINE E SAJ KRENARE



Vendoset Shtatorja e patriotit të madh Ali Ibër Nezaj në qytetin e Bajram Currit,, ngjarje e shënuar për Tropojën dhe kombin!

Ajo përkujtoi 185-vjetorin e lindjes së patriotit të madh, Ali Ibër Nezaj, me një ngjarje të shënuar, vendosjen e shtatores së tij në qendër të qytetit, përkrah monumenteve të tre emrave të mëdhenj të historisë së kombit shqiptar, Heronje të Popullit, Bajram Curri e Asim Vokshi dhe Heroit të Demokracisë, Azem Hajdari.

Tropoja e dashur, e vlerave më të larta njerëzore, patriotike e kulturore, simbol i atdhedashurisë e patriotizmit, qëndresës dhe forcës goditëse ndaj armiqve tanë, krenohet me kontributet e bijve të saj për çështjen shqiptare në momentet me vendimtare për të ardhmen e kombit tonë, nga Epoka e Skënderbeut, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Shpallja e Pavarësisë dhe deri në Lëvizjen Demokratike të Dhjetorit '90.'

**TROPOJA**  
**"ERA E NDRYSHIMIT QE PERKUND TE ARDHMEN E NDRITUR TE KETIJ VENDI"**

---

**FJALA E RASTIT E KRYETARIT TE V  
BASHKISE NE CEREMONINE E VENDOSJES SE PERMENDORES SE ALI IBER  
NEZAJ**

**TROPOJE, 14 NENTOR 2020**

Të nderuar bashkëqytetarë!

Të nderuar vëllezër nga Kosova dhe treva të tjera shqiptare! Miq dhe dashamirës nga krejt Shqipëria!

Padyshim sot është një ditë e madhe dhe e shënuar për Malsinë e Gjakovës dhe Tropojën!

Dita kur Ali Ibër Neza ka vendosur të jetë përgjithmonë në mesin tonë, me një përmendore të bukur dhe madhështore, siç ishte madhështore jeta dhe veprimtaria e tij atdhetare dhe patriotike. Ai ka qënë dhe do të jetë përfjetë i paharruar në zemrat tona për gjithçka që dha për atdheun e tij, por nga sot e në vazhdim dielli do të lindë më ndryshe, duke pasqyruar rrezet e para mbi portretin e bronxtë të heroit dhe hëna do të reflektojë dritën e saj të ëmbël mbi supet e tij, ku pushon krenare historia e luftës për liri dhe pavarësi. Me 12 Tetor 2012 shtatorja e Ali Ibër Nezajt u vendos së pari mu në qëndër të Gjakovës, për të cilën ai luftoi dhe dha jetën e tij, në një ceremoni madhështore me praninë e njerëzve më të nderuar të kombit, sot shtatorja e tij vendoset në Tropojë, bash në vatrën e pashuar në shekuj të luftës për mbijetesën e kombit shqiptar.

Ali Ibër Nezaj është një nga figurat më të ndritura të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të. Ai u lind në vitin 1835 në Shipshan të Malsisë së Gjakovës. Nga viti 1862 e deri sa ndrrroi jetë, në vitin 1900, ishte figurë qendrore, luftëtar dhe prijës popullor, në të gjitha kryengritjet dhe betejat e organizuara në Tropojë, Kosovë, Plavë-Guci etj.

Ai ishte organizator dhe udhëheqës i forcave të Krahinës së Gashit. Ishte një ndër udhëheqësit kryesorë në luftën e Qafë Previsë, më 1874, kundër forcave pushtuese malazeze. Me 10 Qershor 1878, ishte njëri nga organizatorët dhe themeluesit e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe anëtar i zgjedhur i Komitetit Qendorr të Lidhjes.

Bashkë me Sulejman Vokshin dhe Ahmet Korenicën, udhëhoqën betejën e pare ushtarake të Lidhjes në Shtator 1878 në Gjakovë, ku mbeti i vrarë Mehmet Ali Pasha, i dërguar i Portës së Lartë, që kishte ardhur ti dorëzonte Malit të Zi krahinat shqiptare të Plavës dhe Gucisë, sipas vendimeve të Kongresit të Berlinit.

Në dhjetor 1879 dhe janar 1880, bashkë me Ali Pashë Gucinë, Ali Ibër Nezaj është udhëheqësi kryesor i forcave luftarake, të cilat thyen forcat malazeze të komanduara nga Mark Milani. Ali Ibër Nezaj i përkiste krahut autonomist të Lidhjes së Prizrenit, ndërkokë që disa anëtarë të Lidhjes devijuan nga program i saj fillestar dhe pranuan poste dhe ofiqe nga Sulltani.

Në mars 1880 ai dhe shokët e tij riorganizojnë lidhjen në Gjakovë dhe shpallën Qeverinë e Përkohshme, si organ për realizimin e autonomisë. Në fakt pas kohës së Skenderbeut, kjo ishte qeveria e pare kombëtare, e vertetë, ku komendant i forcave ushtarake ishte Sulejman

Vokshi dhe zëvëndës komandant Ali Ibër Nezaj.Në betejën me forcat e Portës së Lartë, për të shtypur lidhjen, në Shtimje dhe Kaçanik, tre komandantë ishin Sulejman Vokshi, Ali ibër Nezaj dhe Mic Sokoli.Në beteje bie heroikisht Mic Sokoli, thyhet Lidhja Shqiptare e Prizrenit, por nuk asgjësohet ajo.Në Shipshan strehohet në kullën e Ali Ibër Nezajt, Sulejman Vokshi, Ymer Prizreni dhe udhëheqës të tjerë të Lidhjes.

Gjatë viteve 1881-1885 Ali Ibra dhe Sulejman Vokshi udhëheqin disa beteja të tjera, ku Ali Iber Nezaj plagoset dy herë.Në të gjitha dokumentet e kohës ai del si mbrojtës i flaktë i popullsisë shqiptare, kundër tendencave fetare përçarëse, pajtimtar i gjaqeve dhe zbatues i devizës së shqiptarëve”Feja e shqiptarit është shqiptaria”

Familja e Ali Ibër Nezës zotëronte pak tokë në Shipshan, më vonë ai bleu tokë e shtëpi në Kosovë, në Rrafshin e Dukagjinit, në fshatin Osek , afér Gjakovës, ku do të jetonte deri në vdekje.Mqedisi ku u lind, edukua dhe u rrit, Ali Ibër Nezaj, Gashi, prijesja e fiseve në betejat për liri, i dhanë atij forcë dhe karakter të veçantë:

“Ku po del kjo flakë e verdhë

Gashi i Gurit si çdo herë...”

Ky fis dhe kjo shteti malësore e Nezaje, nxorri breza të tërë patriotësh dhe atdhetarësh, ku spikar madhërishë figura e Ali Ibër Nezaje:



**TROPOJA**  
**"ERA E NDRYSHIMIT QE PERKUND TE ARDHMEN E NDRITUR TE KETIJ VENDI"**

"Ketu nuk hin as krajl as mbret

Pa u farue Malsia krejt..."

Ali ibër Nezaj kishte tërë Tropojën me vete, por edhe Rekën, Hasin deri në Prizeren. Porta e Lartë Turke e ftoi ti jepte grade Pasha, por ai preferoi të jetë konsequent me idetë dhe veprimtarinë e tij për liri dhe pavarësi.

I mënjanuar, në shtëpinë e tij në Osek të Gjakovës, rrëthuar nga shokë dhe miq kalon vitet e fundit të jetës, me plagë dhe sëmundje të shumta, por me humor, besim dhe në kuvend të vazhdueshëm me forcat atdhetare dhe progressive të kohës. Pas tridhjetë viteve qendresë, me pushkë në dorë, mbylli sytë dhe u varros aty me percjellje madhështore të popullit të vet, që e kujton gjithmone birin e vet të trimnisë dhe fjalës së urtë, në luftën për bashkimin e trojeve amtare.

Të nderuar pjesëmarrës! Ali Ibra është sot në Osek, është sot në Gjakovë, është sot në Tropojë! Simbolikisht sot i ngrejmë piedestalin e bronxtë, ndërkohë që në zemrat tona ka gjithmonë piedestalin e tij të artë të dashurisë dhe mirënjojjes!

E gëzofsh përmendoren Malësia e Gjakovës!

Tropojë, 14 Nëntor 2020

4

**DITARI I AKTIVITETEVE KRYESORE TE BASHKISE TROPOJE**

**13 GUSHT 2020-13 DHJETOR 2020**

Sot një vit u zgjodha në krye të Bashkise Tropojë nga bashkëqytetarët e mi. Nuk është në interesin e tyre dhe as në zakonin tim 28-vjeçar në shërbimin publik të bëj paradë suksesesh dhe as të polemizoj me ata që refuzojnë te shohin e të dëgjojnë.

Dëshpërimi i pushtetit të humbur dhe i pandemisë janë me pasoja, por për hir të transparencës ndaj qytetarëve dhe në respekt të stafit që më ka shoqëruar me përkushtim në këtë sfidë obligohem të bëj një përbledhje të shkurtër:

Me 13 gusht 2019 trashëguam një institucion të shkatërruar jo vetëm finansiarisht e materialisht, por më tepër një kontigjent mitingashësh sesa shërbetorësh publike. Me borxhe të rënda të trashëgura, me punë publike të papaguara, me mjete shërbimi totalisht të amortizuara.

Në tërësinë e tij qyteti përveç qëndrës ishte kthyer në një xhungël ferrash e mbeturinash. Sistemi i kanalizimit të vaditjes prej 7 vitesh ishte jashtë funksioni dhe ai ekzistues ishte shkatërruar e abuzuar. Administata deri në njësitë administrative ishte jo vetëm politike por tërësht nepotike ku nga një familje kishte deri në 13 pjestarë, që paguheshin dhe pa qenë prezent në Shqipëri.

Mungonte komunikimi me qytetarët dhe drejtimi i bashkisë kryhej part-time nga kryeqyteti.

Bashkia me grantet dhe fondet e saj kishte kryer zero investim dhe manipulonte me investimet direkte të qeverisë shqiptare.

Mungonte komunikimi me qytetarët dhe transparenca me publikun duke e konsideruar godinën e Bashkisë si çiflig privat. Në 12 muaj u bë e mundur që ndonëse në kushte të rënda

post-termeti dhe pandemie të rëndë globale qytetarëve të Tropojës ,në 1043 km të saj të mos i mungojnë shërbimet bazë publike.

U ndërtua dhe u riparua sistemi kapilar i ujitjes në të gjithë rrrethin, duke funksionalizuar një bord ujitje e kullimi të suksesshëm.

Komunikimi im dhe stafit me qytetarët ka qenë i përditshëm,i hapur e pa limit ,duke u bërë pjesë e hallevë dhe e zgjidhjes se tyre. U ndërtua një rrjet eficent humanitar gjatë gjithë kohës, duke ju ardhur në ndihmë individëve e familjeve në nevoje me pako ushqimore,ilaçe e shërbime të tjera të domosdoshme.



Puna ime si drejtues është të sigurohem që çdokush në administratë të ketë mundësi të mira dhe të ndjej që ka impakt të rëndësishëm.Me një pjesë të stafit tim,faleminderit secilit për korrekëtesin e punës dhe cilësin e shërbimit që i ofroni komunititetit.



U dezinfektuan sistematikisht gjithë ambjentet publike,shendetësore,si banesat e qytetarëve të prekur me Covid.Filloi zbatimi i realizimit të veprave infrastrukturore dhe kulturoro-sportive me fondet e alokuara nga qeveria.

Kështu që është në perfundim Unaza e qytetit,palestra e gjimnazit "Asim Vokshi" si dhe dy ujësjellësit e financuar nga BERZH dhe qeveriashqiptare.

Janë pritur e nderuar figura të rëndësishme kombëtare të fushave të ndryshme.

Ka perfunduar projekti nga kompani projektuese të njoitura të shumë veprave të tjera infrastrukturore dhe jetësimi i tyre do të jetë afat shkurtër.Janë siguruar fonde të rëndësishme si ato të kanalizimeve në Luginën e Valbonës apo ndërtimi i dhjetra apartamenteve sociale për të pastrehët.

**TROPOJA**  
**"ERA E NDRYSHIMIT QE PERKUND TE ARDHMEN E NDRITUR TE KETIJ VENDI"**



Janë mbjellur mijra fidane pemë e lule dekorative, duke krijuar një ambjent të shëndoshë për qytetarët dhe turistët.

Ka vijuar pregetitja serioze dhe promovimi i Turizmit në çdo krahinë të Tropojës. Ndonëse në kushte të kufizimit,jeta kulturore e sportive në Tropojë nuk ka pushuar për asnjë cast, duke kontribuar direkt dhe ne dokumentimin e folkut tonë për tu pranuar si pjesë botërore në UNESCO.



Janë ngritur dhe funksionojnë strukturat e Integrimit dhe ndihmës së huaj dhe aplikime të rëndesishme finannciare janë në proces.

Këto pak radhë nuk përbledhin gjithë punën dhe përkushtimin e stafit tonë, por me i rëndësishëm

është ndyshimi i mentalitetit qeverisës në Tropojë, duke e shndrruar bashkinë në pronë të qytetareve dhe ne shërbëtore të tyre.



"Së bashku për Tropojën" tashmë nuk është slogan elektoral, por realitet praktik që do vijojë deri në ditën e fundit të mandatit, në Qershor 2023.

Bashkia Tropoje siç ka ndodhur në 12 muaj, do vijojë të jetë shtëpia e qytetarëve dhe jo seli partie e propagandë.



-Rexhë Byberaj-

**TROPOJA**  
**"ERA E NDRYSHIMIT QE PERKUND TE ARDHMEN E NDRITUR TE KETIJ VENDI"**

**16.02.2020**

Sot se bashku me Z.Blenди Klosi Minister i Turizmit dhe Mjedisit, mora pjesë në ceremoninë e ndarjes se Çertifikatave të performancës për disa Hotele dhe resorte të zonës së Valbonës si dhe pëurimin e aktivitetit permanent të një Kompanie të njojur helikopterësh e cila do të operojë në Alpet tona për turizmin elitar.



Jko zonë e rëndësishme po shndrrrohet në një industri turistike e standardeve bashkëkohore!

**22/02/2020**

Sot pata kënaqësinë të pres familjen e Dr.Isa Zllami, emrin e të cilit do ta gëzoje Spitali i Tropojës, ku mjeku i shquar shërbeu me profesionalizëm dhe humanizëm për dekada. Mirënjohje dhe homazh per punën e tij dhe të një plejade mjekësh e intelektualësh të devotshëm, që lanë djersën dhe mundin e tyre në Malësinë e Gjakovës. Po ashtu mirënjohje e veçantë për Këshillin Bashkiak Tropoje, që me unanimitet ju përgjigji propozimit tim. Veçanërisht respekt për Spatalin Tropoje dhe personelin e tij, që masivisht u angazhua në mbarëvajtjen e kësaj ceremonie. Tropoja është vatër e njerëzve të shquar në çdo fushë, ndaj sa herë është rasti marr seriozisht propozimet për përkujtimin e tyre. Një falenderim i veçantë për familjen e Dr.Zllamit, që vijon në traditën e shkelqyer të humanizmit që doktori manifestoi gjatë gjithë jetës së tij.

Po ashtu mirënjohje e veçantë për Këshillin Bashkiak Tropoje që me unanimitet ju përgjigji propozimit tim.

**05/03/2020**

Sot në një atmosferë festive të veçantë prita në Tropojë pjestarë te Familjes Jasharaj dhe personalitetë të tjera të Kosovës si ish-Presidenti Fatmir Sejdiu, të cilët asistuan në dhënjen e titullit "Nderi i Tropojës" familjes legjendare Jasharaj, akorduar nga Këshilli Bashkiak.



Një ceremoni madhështore, që kulmoi me një paradë festive masive në Pallatin e Sporteve "Valbona" dhe në sheshin kryesor të qytetit të Bajram Currit.

Evenimentit ja shtoi emocionet edhe dhënja e titullit "Qyetare Nderi" ushtarakes tropojane Zarife Hasanaj e cila dha jetën ne një mision të NATO në Letoni.

Zgjodhëm një ditë të veçantë 5 marsin, ditën e epopesë se UÇK-së kur Tropoja i akordon mirënjojje Familjes Jashari, që të nderojme me shume veneracion e krenari dhe vajzën heroine të Tropojës. Një koiçidencë që në fakt është shumë kuptimplotë. Homazh për Zarife Hasanaj dhe ndirim për familjen e saj, që e rriti dhe e brumosi me guximin njerëzor dhe besimin hyjnor te liria.



07/03/2020



Festa e 7-Marsit në Tropojë u shndrrua si asnjëherë në një bashkim të gjithë mësuesve të Bashkisë sonë në një drekë te shkëlqyer shoqëruar me muzike dhe hare!

**TROPOJA**  
**"ERA E NDRYSHIMIT QE PERKUND TE ARDHMEN E NDRITUR TE KETIJ VENDI"**



Si kryetar i Bashkisë pranova propozimet e drejtuesve të shkollave dhe ZVA, duke akorduar mirënjojje per mësuesit me arritje profesionale te veçanta.Në fjalën time theksova se Tropojës i duhet kthyer shkëlqimi që e ka bërë të dallueshme ndër dekada, për një arsimim efektiv dhe me rezultate.

E ardhmja e një kombi ka peshën e shkollimit dhe të dijes.Mësuesit e Bashkisë Tropoë mbeten krenari e saj.

**25.03.2020**



Edhe sot stafi ynë bashkiak i emergjencës ka vazhduar shpërndarjen e pakove me ndihma ushqimore bazë në familjet dhe individët në nevojë.

Asnjëherë nuk do të mungojë falenderimi im dhe mirënjojja e veçantë për bisnesmenet bujare të Tropojës ,të cilët po i gjenden komunitetit ne keto momente të vështira njerëzore.



I tillë ishte sot dhe gjesti i dhurimit fisnik të pakove ushqimore nga bisnesmeni Erzen Breçani dhe Kompania "Gener 2". Situata të tilla të rënda janë provë e solidaritetit human dhe e finikërisë që e ka karakterizuar ndër shekuj Malësinë e Gjakovës!

Një mirënjoje për të gjithë bashkqytetarët tanë për mirëkuptimin dhe korrektësinë ndaj vendimeve lokale e qeveritare të kufizimit të lëvizjeve!

03.04.2020



Edhe sot për 12 orë rrjesht stafi i emergjencës së Bashkisë Tropojë vijoi me shpërndarjen e një pakete ndihmë për familjet e Njesisë Administrative Bytyç.

Banorëve të fshatrave;

Pac,Vlad,Çorraj,Leniq,Zherkë,Kepenek,Zogaj e Prush ju dorëzua ky donacion i bisnesmenit të njohur Rame Geci i cili dha një shëmbull model suporti financiar dhe humanizmi.

08.04.2020



Por lajmëtarët e jetës në Tropojë.Publikisht shpreh mirënjoje për pronarin bujar të Kompanisë z.Andi Gjoka dhe mikun e tij,bashkëqytetarin tonë Agron Brahaj për këtë gjest shumë fisnik.

Ndoshta duket e pazakontë për kohën troditëse që po kalojmë, por për mua dhe punonjësit e Bashkisë Tropojë sot ishte një përjetim prekes gjesti i dhuratës që na u bë nga Firma e Luleve Fushë Krujë, të cilat që sot do të zbukurojnë qytetin e Bajram Currit.

Plot 2700 vazo lulesh dekorative do të jenë jo vetëm lajmëtarët e pranverës,

18/04/2020



qeverinë shqiptare e cila ju përgjigj kërkesës dhe apelit tim !

Ndjehem veçanërisht mirë, që pikërisht në përvjetorin e parë të mandatit tim në krye te Bashkisë Tropoje, përfundova dhe procedurat e fundit juridike për alokimin nga qeveria shqiptare të 2.6 miliarde lekë për ndërtimin e banesave për familjet në nevojë strehimi. Kjo është një zgjidhje afatgjatë për strehimin në qytetin tonë ndaj dua të përshendes me gjithë zemër


18/04/2020

Me moton "Në Tropojëjeta nuk ndalet" pa e ndërprerë detyrën ditore të ndihmës e solidaritetit te çdo familje në nevojë, Bashkia Tropoje po punon intensivisht për hapjen dhe pastrimin e kanaleve ujitëse. Eshtë objktivi ynë që çdo pëllëmbë tokë në Tropoje të mund të mbillet e ujitet pasi kjo lidhet direkt me mirëqenjen dhe ekonominë e fermerëve dhe blegtorëve dhe po ashtu me turizmin.

Falenderoj administratorët, Bordin e Ujitjes dhe Kullimit si dhe kryetarët e fshatrave, që po i përgjigjen jo vetëm me pozitivitet iniciativës time, por edhe me përgjegjshmëri e përkushtim të pashoq.

Sot vijoi përsëri puna për kanalin Ahmataj-Hasaj-Sopot i cili do të bëjë të mundur vaditjen e 80 ha tokë që fatkeqesisht për 7 vite ka qenë në pamundësi totale të marrjes se ujit.

16 /05/2020



Kontrolli i territorit në çdo aspekt është tagër dhe detyrë e pushtetit vendor ndaj me ndihmën e komunitetit ky kontroll do forcohet e do jetë rigoroz konform të gjithë ligjeve në fuqi. Pikërisht për këtë problem sot u zhvillua në qytetin e Bajram Currit një takim i zgjeruar i stafit tim, së bashku me të gjithë drejtuesit e Njësive Administrative, këshilltarët lokale, kryetarët e fshatrave si dhe faktorë relevantë të shoqërisë civile. Morën pjesë Prefekti i Qarkut Z.Zenel Kuçana si dhe

drejtuesit kryesore të Policisë së Shtetit në Qarkun Kukës dhe Bashkinë Tropojë.

-Tropoja do të fshihet përgjithmonë nga harta kriminale e kultivimit të bimëve narkotike.

- Do të këtë kontroll të rreptë të ndërtimeve pa leje dhe do penalizohen të gjithë pa përjashtim, që cenojnë jashtë rregullave urbanistikë e orientuar.

-Ruatja dhe administrimi i pyjeve do të jetë objektiv parësor.

-Pastrimi i territorit dhe menaxhimi i mbetjeve urbane është prioritet sistematik pasi lidhet direkt me shendetin e qytetarëve dhe turizmin.

Bashkia Tropojë mbetet e angazhuar që të intensifikojë përdorimin e të gjithë burimeve te saj logjistike njerëzore dhe funksionalizimin e ligjeve, në mënyrë që Tropojës turistike ti krijohet imazhi që meriton, duke e shndrruar në një destinacion kryesor kombëtar të turizmit të gjelbër.

**25/04/2020**



Kjo ditë do të ngelet e shënuar për çdo banor e admirues të bukurive natyrore të fshatit Çerem të Tropojës. Pas 30 vitesh sot u lidh energjia elektrike.

Personalisht jam shumëfish i lumtur, pasi mu dha rasti që pas 5 vite shkeputje nga ky komunitet i mrekullueshem, të rinis me energji e vullnet projektet e shumta, të lëna përgjysëm.

Këtë dhuratë bujare të Zotit tani do të kenë mundësi ta shijojnë banorët e rikthyer, të cilët po investojnë për turistët e shumtë, që presin ta vizitojnë.

Edhe njëherë mirënjoye Kompanise OSHEE dhe posaçërisht drejtuesve Afrim Hoda e Sami Imeraj dhe gjithë ekipit realizues, që në kohë rekord realizuan një investim të domosdoshëm për të cilin askush nuk është kujtuar në 3 dekada.

Mirënjoye të gjithë drejtuesve të institucioneve të Tropojës dhe banorëve të shumtë të Çeremit, që ndamë së bashku këtë ditë arritjeje me të vertet impresionuese.



**19.04.2020**



E diela eshte dite pune intensive për stafin e Njësisë Administrative Margegaj, për të kompletuar dhe fshatrat më te thella me ndihma të çdo familje të izoluar e në nevojë. 50 familje u asistuan në fshatrat Dragobi, Valbonë, Çerem e Rragam.

Ky nuk eshte fundi i misionit tonë dhe i detyrës që kemi ndaj çdo qytetari, por natyrisht ndjehemi krenar që ne këto momente të zorshme kemi shfrytëzuar së bashku me stafin tim çdo mundësi, për ti ardhur e përgjigjur

secilit me ndihmë. Gjej rast të falenderoj me mirënjojje mijëra banorë të Malësisë së Gjakovës, që jo vetëm kanë shprehur konsideratën e mirë për punën tonë, por së pari që i janë përgjigjur thirrjes për të vepruar konform rregullave te përcaktuara.

**30.04.2020**



Me moton "Dhuro gjak e shpëto jetë" sot së bashku me stafin tim të Bashkise Tropoje u drejtuam për ne spitalin e qytetit.



vijojë dhe Banka e Gjakut që shpëton jetë njerëzore nuk do ta ndjejë asnjëherë krizën falë solidaritetit e qytetarisë së Tropojës!

**02.05.2020**



Sot prita së bashku me stafin tim, Drejtorin e Emergjencave Civile Z. Haki Cako si dhe drejtues e ushtarake të FA dhe se bashku asistuan ne shperndarjen e 200 paketave ushqimore dedikuar kryesisht për familjet e individëve me invaliditet dhe nevoja të vecantë të Tropojës.

Ky kontribut i sotëm i Qeverisë Shqiptare është vijim i punës sonë 63 ditore pa ndërprerje për t'ju ardhur në ndihmë të gjithë familjeve në nevojë.

Edhe një herë mirënjojje për të gjithë donatorët e asosacionet humanitare që ju përgjigjen apelit tim.

Tropoja edhe në këtë kohe të zorshme globale e demostroi shpirtin e saj humanist e fisnik!



Falenderoj me shumë mirënjojje të gjithë ata që ju përgjigjen thirrjes time humane pasi që asnjëherë me shumë nuk nevojitet solidariteti.

Gjesti ynë përvçse kontribut jetik për jetët njerëzore është dhe ndjenjë respekti për personelin e Spitalit Bashkiak të Tropojës, të cilët në këtë kohë të vështirë pandemie globale demonstruan profesionalizëm, përkushtim e devotshmëri. Aksioni ynë do të

TROPOJA

**"ERA E NDRYSHIMIT QE PERKUND TE ARDHMEN E NDRITUR TE KETUJ VENDI"**


03/05/2020



Ndonëse ishte ditë e diel dhe kohë jo shumë përshtatshme, stafi komunal i Bashkisë tonë nuk e ndali për asnjë çast punën në fshatin Viçidol përfunktionalizimin e kanaleve të vaditjes.

Falenderoj me mirënjojje të gjithë punonjësit tanë ,që megjithëse në situate pandemie i janë përgjigjur apelit tim dhe rezervuari i fshatit Kasaj,një investim i bllokuar prej shumë vitesh,të vihej në shërbim sistematik për sezonin veror te ujites.Eshtë jo vetëm objektivi dhe premtimi ynë, por një domosdoshmeri emergjente që të gjitha tokat e Tropojës të mbillen e vaditen pasi kemi burime të mëdha, të cilat duhet ti shfrytëzojme në të mirën e familjeve tona dhe komunitetit.

07/05/2020



Jam i lumtur të ndaj sot me ju një lajm shumë të rëndësishëm jo vetëm për banorët e Valbonës, por për gjithë komunitetin e Tropojës dhe mijra turistë që frekuentojnë këtë perlë te turizmit.

Pas kërkesës time për investim në trajtimin e ujërave të zeza në këtë zonë sot mora përgjigje pozitive.Fondi Shqiptar i Zhvillimit sa po me njoftoi zyrtarisht se Qeveria shqiptare miratoi këtë investim, i cili kalon shumën e 700.000 000 lekë.Valbona tashmë do të ketë një infrastrukturë në zhvillim, duke plotesuar standartet më të përparuara të turizmit elitar.

02/06/2020

Pas një pune vertetë me sakrifica ,sot u bë e mundur përfundimisht lëshimi funksional i Kanalit te Gashit, i cili pas shumë kohesh do të garantojë ujë për vaditje 24 orë, për dhjetra hektarë tokë të fermerëve të kësaj zone.

09/06/2020



Sot pata kënaqësinë e veçantë që së bashku me stafin tim të inspekoj përfundimin e arredimit dhe të pajisjes logistike si dhe dixhitalizimit të Zyrave të Integrimit Evropian dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj pranë Bashkisë Tropojë.Si kryetar i bashkisë jo vetëm do konsideroj dhe do bashkëpunoj ngushtë me këtë zyre, por siç e theksoi Ambasadori Soreca do ta trajtojmë si ambasadore të BE-se në Bashkinë tonë.

01.07.2020



tonë.

Po ky zotëri vitin që kaloi i dhuroi Bashkisë Tropojë në automjet për shpërndarjen e

Solidariteti demostrohet në kohë të veshtira si kjo e pandemisë.Këtë e tregon dhe gjesti fisnik e bujar i biznesmenit me origjinë nga Tropoja z.Florian Lushaj,pronar i Kompanise L.Construzioni Societa" i cili i huazoi bashkisë tonë një Autobot, i cili do të përdoret për dezinfektimin e ambjenteve në territorin



kripës gjatë ngricave dimërore.

E vlerësoj pa masë këtë gjest humanizmi publik sikundër të shumë bashkëqytetarëve tanë të fushës së biznesit të cilët që prej ditës së parë të Pandemisë nuk kanë reshtur së ofruari kontributetin e tyre.

**23/07/2020**



Pas sistemimit,zgjerimit,kanalizimit dhe shtrimit në parametra bashkëkohore dje filloj asfaltimi i Unazës së re të Qytetit Bajram Curri.

Ky investim i Qeverisë shqiptare është një risi e mirëpritur pasi i jep frymëmarrje infrastrukturore qytetit tonë në çdo cep të tij, pasi qe fatkeqësisht jo vetëm ishte lënë pas dore, por ishte

kthyer në një geto të pabanueshme shume afér qendrës së tij.

Tashmë ka filluar rikonstruksioni e zgjerimi i rrugës lidhëse të bjeshkëve, një projekt i hershëm i lënë përgjysëm.Jo vetëm qyteti e Valbona, por Lugina e Çeremit,Bjeshkët,zona brilante e Nikaj Merturit dhe Lumit të Gashit, do të marrin vemendje të posaçme dhe do të shndrrohen në kënaqësi për vizitorët dhe në të ardhura ekonomike për banorët.

**23/07/2020**



Dje ndonëse në një festë spontane. për shkak të limiteve nga pandemia,në kuadrin e promovimit të vlerave turistike dhe me gjerë të jeshkëve të Tropojës,ngela i mrekulluar dhe i surprizuar nga pritja dhe organizimi në Sylbicë të Bytyçit. Ripërtëritje dhe ruajtje e traditës së mikpritjes,bujarisë,

por dhe e riteve festive të cilat u demonstruan në Logun e Bjeshkëve . Gjek rastin të shpreh mirënjojen time për mikpritjen e veçantë te z.Gëzim Koka dhe të familjes së tij, të cilët kanë krijuar modelin sesi me punë e djersë mund t'ja dalësh.

Po ashtu një falenderim i veçantë për artistët e gjithë moshave, të cilët nën drejtimin e mjeshtrit Skender Haklaj zbuluan eventin dhe bjeshkët me vallet, meloditë dhe harenë e tyre.



**06.10.2020**

Kryeligji i botës së sotme është ai i ruajtjes së mjedisit.

Nuk ka integritet më të madh e më të epërm se integriteti i natyrës.



Një falenderim të përzemërt dhe mirënjoyje për të gjithë ata që morën këtë nismë për pastrimin e Valbones dhe dëshiroj që kjo nismë mos të jetë vetëm pastrim ditor, por dhe ndërgjegjësim për të gjithë komunitetin për ruajtjen e ambientit.



**10.10.2020**



Bardha”rreth 1000 m lartësi.

Mirënjoyhe dhe falëndërimë për stafin e punës dhe për mirkuptimin e banorëve.

**16/10/2020**



Falënderim i madh për të gjithë ekipin e punës që pavarësisht vështirësive kanë punuar me përkushtim të madh dhe pa reshtur, për të kthyer në normalitet rrugën në bjeshkën e Sylbicës, që si pasojë e reshjeve të ditëve të fundit doli jashtë funksionit ku mbeten të bllokuar disa banorë bashkë me bagëtitë.

Por veç kësaj dëmtime kishte dhe në ujësjellësin që furnizon me ujë disa fshatra të Njësisë Administrative Tropojë linjë e cila ka burimin në “Përlinat e

Me rastin e 76 -vjetorit të Çlirimtës Tropojës zhvilluan një ceremoni tek Varrezat e Dëshmorëve ndoshta e vogël nga pjesëmarrja, për shkak të pandemisë, por e madhe në kuptimin që mban kjo datë historike për të gjithë. Përusemi me respekt përpëra heroizmit, luftës dhe sakrificave të dëshmorëve që derdhën gjakun jo vetëm për çlirimin e qytetit tonë, por edhe për të gjithë luftëtarët e lirisë që kontribuan në “Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare”

■ Lavdi Dëshmorëve



modelli so mësimor po mësimdhënues  
sot që sot këtë vërtetë nuk

**22/10/2020**

60 vjetori i Gjimnazit "Asim Vokshi"



Nën moton "Kujtojmë për të mos harruar", ky gjimnaz kremltoi me madhështi 60 vjetorin e tij, duke zbatuar deri në detaj Projektin : Gjimnazi Asim Vokshi -60 vjet vatër e dijes ,krenari e Malësisë së Gjakovës .

Ky projekt synonte promovimin e vlerave dhe historisë së suksesit të gjimnazit në 60 vite ,si një vatër e fuqishme e përhapjes së dijes dhe arsimit në Tropojë .

Pas aktiviteteve të larmishme të zhvilluara gjatë gjithë muajit ,22 Nëntori do të kthehet në ditë festë jo


vetëm për gjimnazin ,por për mbarë rrethin e Tropojës, duke u jetësuar gjatë në memorjen e gjithë komunitetit arsimdashës tropojan.

**TROPOJA**  
**"ERA E NDRYSHIMIT QE PERKUND TE ARDHMEN E NDRITUR TE KETIJ VENDI"**



Atmosfera festive mes mësuesve dhe nxënësve, ndihej që në mëngjes. Tapeti i kuq u shtrua për të pritur e nderuar mysfirët e të ftuarit, të cilët vizituan së pari muzeun historik të shkollës "Gjimnazi në breza", e më pas laboratoret e reja, si dhe ambjentet e shkollës së rikonstruktuar.





Të gjithë me respektin dhe nderimin më të madh ,pritën vizitorë të shumtë , ish mësues dhe ish-nxënës që nga matura e parë,mësues e të ftuar nga Kosova ,miq e të afërm të familjes Vokshi , drejtues institucionesh , intelektualë të ndryshëm ,të cilët emocionoheshin tek gjenin veten në një kënd të këtij muzeu.

Gëzim ,nostalgji ,vlerësimë pa fund ,për mësuesit dhe aktorët kontribues në ngritjen e një muzeu të tillë .

Pas vizitës në muze dhe ambjentet e shkollës ,të ftuarit , në shenjë respekti e nostalgje vizituan shkollën 9-vjeçare” Konferanca e Bujanit” ,ish godina e parë ,ku hodhi hapat e parë gjimnazi “Asim Vokshi ”



Z.Fran Bushgjoka ,në emër të mësuesve në vite ish -Mësuesi i Merituar z. Mehmet Hyka ,Drejtori i Zyrës Arsimore Vendore

Z. Petrit Zenelaj ,në emër të nxënësve ekselentë ish-gjimnazisti me Medalje të Artë z.Sadri Isufi , ish -gjimnazisti i Maturës së Parë,z. Pjetër Meta ,si dhe dy ish-gjimnazistët e suksesshëm dhe personalitetë me emër ,Z. Avni Ponari dhe Z. Petrit Malaj .

Mysafiri i nderit ishte aktori i madh Reshat Arbana "Artist i Popullit ", "Nderi i Kombit". Pas përvendetjeve Kryetari i Bashkisë Z.Rexhë Byberi me propozimin e tij dhe miratimin e Këshillit Bashkiak vlerësoi me titullin "Nderi i Tropojës"

Maturën e Parë 1959-1963 si dhe gjimnazin "Asim Vokshi "me këtë motivacion:

Për kontribut të shquar ndër vite në fushën e arsimit dhe të edukimit të brezive" . Gjithashtu me propozimin e kryetarit të Bashkisë z. Rexhë Byberaj dhe miratimin e Prefektit të Qarkut Kukës, z. Zenel Kuçana ,u vlerësuan me titullin " Qytetar Nderi " 17 ish-mësues të nderuar ,tashmë në pension



z.Avni Ponari ,me një ftesë publike për çdo ish -gjimnazist .Kujtime dhe foto të paharruara të atij eventi madhështor, pasuan drekën e përgatitur me këtë rast .

Çdo gjë u ndoq dhe u filmua nga gazetarë të televizioneve TvSyriVision Gjakovë ,Ora News ,RTV Ora .Mirënjojhe pa fund për gjithë aktorët bashkëpunues të këtij eventi ,në veçanti, për sponsorët e atij përvjetori të magjishëm :  
Bashkia Bajram Curri dhe Kryetari Rexhë Byberi

Sesioni jubilar "Gjimnazi Asim Vokshi " vatër e dijes dhe krenari e Tropojës u zhvillua në Pallatin e Kulturës Dardania.Hapi dhe përvendetet aktivitetin drejtoresha e shkollës znj .Shotë Bashaj e cila bëri një ekspozë të plotë të punës dhe ,arritjeve të gjimnazit në 60 vite .

Përvendetet gjithashtu në sesionin jubilar në emër të Këshillit të Ministrave Prefekti i Qarkut Kukës z. Zenel Kuçana , Kryetari i Bashkisë z.Rexhë Byberi ,në emër të drejtuesve në vite ,ish- drejtori i gjimnazit

Aktiviteti i zgjeruar festiv ,me mësues dhe ish-nxënës të gjimnazit ,si dhe të ftuar të tjera u organizua ne stadiumin e qytetit,ku nxënësit me një manifestim sportiv , formuan numrin 60 simbol të përvjetorit të gjimnazit " Asim Vokshi ",si dhe përvendetet të pranishmit me programin kulturoro-artistik . Atmosfera festive me këngët dhe vallet tropojane krijuan një mjeshtë ngrohtë ,gjatë drekës së organizuar dhe financuar nga

Avni Ponari ish -gjimnazist ,Artan Metalaj ish-gjimnazist,Abedin Katana ,ish-gjimnazist dhe mësues pranë këtij gjimnazi .Përvjetore të tilla suksesi e krenarie kremitofshim gjithmonë .

**22/10/2020**

Në kuadër të " Ditës evropiane të trafikimit të qenieve njerëzore" gjatë muajit tetor NJMF dhe Barazia Gjinore dhe Bashkia Tropojë organizoi aktivitetet në zbatim të kalendarit të muajit " Antitrafikim " në bashkëpunim me:

- 1 . Shërbimin Social Shtetërorë Kukës .
- 2 . Përfaqësues të Prefekturës ( Anëtarë të Tryezës Antitrafikim ).
- 3 . Shoqatën Mary Ward Loreto ,Dega Tropojë .
- 4 . Njësin Psiko-sociale ZVA Tropojë .
- 5 . Gjimnazi "Asim Vokshi ".
- 6 . Shkolla 9-vjeçare " Besëlidhja e Malësisë ".
- 7 . Shkolla 9-vjeçare " Konferanca e Bujanit ".

Me sloganin : Ti themi stop trafikimit të qenieve njerëzore "


( Unë frymoj nuk jam produktë për tu shitur )

U zhvilluan takime ndërgjegjësuese me nxënësit e këtyre shkollave ,u hartuan dhe u shpërndanë fletëpalosje informuese ,spote me mesazhe ,foto rrëth fenomenit të trafikimit .U krijuan ese të ndryshme nga nxënësit dhe ekspozitë me vizatimet e krijuara prej tyre .



**TROPOJA**  
**"ERA E NDRYSHIMIT QE PERKUND TE ARDHMEN E NDRITUR TE KETIJ VENDI"**

19/10/2020



Në bashkëpunim me OSHEE Tropojë bëmë jo vetëm një investim, por një punë të domosdoshme në linjën elektrike të fshatit Berishë, ky investimi bën të rritet ndjeshem cilësia dhe mirëfunksionimi i furnizimit me energji elektrike të asaj zonë. Kur kishte 30-vjet pa u bërë asnjë investim në këtë rrjet shpërndarje të amortizuar.

17.10.2020

Reshet e dendura të shiut që kanë përfshirë vendin ditët e fundit kanë shkaktuar dëmë të konsiderueshme në infrastrukturën rrugore në territorin e Bashkisë Tropojë. Situata e vështirë nuk na mundësoi të gjendeshim në kohë reale pranë çdo segmenti rrugorë për të kthyer normalitetin, ndaj kërkjmë mirëkuptimin e çdo banori.



Falënderoj ekipin e palodhur të shërbimeve, pranë Bashkisë Tropojë që varësisht vështirësive të situatës krijuar punuan pa reshtur dhe u gjëndën pranë komunitetit.

së

18/10/2020



Në Njësinë Administrative Tropojë, fshati Sopot, përfundoi puna për kanalin vaditës, investim ky i domosdoshëm dhe jetik, por i munguar prej vitesh. Ky kanal do t'u vijë në ndihmë banorëve të kësaj zone për të vaditur me qindra hektarë tokë bujqësore.

25.10.2020




Në fshatin Markaj njësia administrative Bujan punimet për hapjen e rrugës vazhdojnë, mirënjojhe dhe falenderime për ekipin e punës. Puna nuk është një virtyt, por një kusht i pashmangshëm i një jete të vertytshme.



**TROPOJA**  
**"ERA E NDRYSHIMIT QE PERKUND TE ARDHMEN E NDRITUR TE KETIJ VENDI"**

**28/10/2020**



Përfundon rikonstruksioni i kopshtit të fëmijëve në Njësinë Administrative Tropojë. Me punë dhe jo me fjalë, po provojmë se kur ne vendosim një objektiv, kur e kthejmë atë në prioritet, asgjë nuk na pengon që këtë prioritet ta plotësojmë, madje as mangësitë dhe as defektet e së shkuarës. Përmirësimi i infrastrukturës arsimore do jetë prioriteti im gjithmonë.

**23/10/2020**

"Festa e Gështenjës" në formën e një panairi për promovimin e gështenjës, karakteristikë e kësaj zone.

Në këtë aktivitet që u zhvillua me suportin e Bashkisë Tropojë, ku u demostruan gatime tradicionale me bazë gështenje si dhe gatime të tjera të zonës.



KËSHILLI I QARKUT  
KUKËS

### FESTA E GËSHTENJËS TROPOJË





**31/10/2020**

Sot pata kënaqësinë e veçantë të mirëpres në Tropojë Kryeministrin e Shqipërise z.Edi



Rama i cili ndër të tjera vizitoi disa nga investimet e qeverisë shqiptare në rrithin tonë.

E falënnderova sinqerisht z.Rama i cili në këto vite ka ndikuar personalisht në adresimin e shumë financimeve të rëndësishme në Bashkinë tonë.

Po ashtu i parashtrova dhe së shpejti besojmë në të tjera projekte strategjike afatgjata të cilat do përmirësojnë rrënjosht nivelin e jetesës së komunitetit.

Tropojës, pas ndërtimit të Stadiumit “Valbona” dhe kthimit të ekipit në Kategorinë e II-të, ju rikthyse si dikur tradita, ndërkohë që vazhdon me përkushtim puna me ekipet zinxhir, falë mbështetjes morale dhe material të Bashkisë Tropojë.

Ashtu si dhe me kthimin e vëmendjes dhe mbështetjes së duhur edhe për sportet e tjera si atletika, volejbolli dhe basketbolli.



**21.11.2020**

eksperteve dhe KM!".

Së bashku me prefektin e qarkut dhe agjencitë ligjzbatuese riorganizuam Task-Forcën e kontrollit në Tropojë dhe sot në bashkpunim me NVKSH dhe ISKSH ndërmorëm një fushatë publike ndërgjegjësimi për përdorimin jo vetëm te maskave, por dhe të kufizimit dhe distancimit në lëvizje.

Sot në shenje solidariteti Ministria e Shendetësisë shpërndau 500 maska si sensibilizim, por mbrojtja me e mirë është kujdesi dhe respekti ndaj ligjit.

E gjithe kjo në emër të jetës. Të zbatosh ligjin është fisnikëri

Besoj se është e pakuptimtë të moralizoj sot si Kryetar i Bashkisë Tropojë, por dhe si bashkëqytetar i juaj për situatën e rëndë e delikate qe ka shkaktuar pandemia edhe në vendlindjen tonë.

Por është rasti të apeloj jo vetëm miqësish por dhe shtetërisht me shumë seriozitet në emër të jetës: "Zbatoni rigorizisht të gjithë protokollet dhe kufizimet e përcaktuara nga komiteti i

**21.11.2020**

lokal, të delegacionit të BE, projektit Bashkitë për në Evropë, AMVV etj. Kryetari i Bashkisë Tropojë, Z. Rexhe Byberi:

"Kjo analizë është e rëndësishme sot më shumë se asnjëherë pasi vendi ynë ka hyrë në një fazë të veçantë dhe delikate të Integrimit në BE. Duke u ndalur te arritjet dhe dobësitë që janë konstatuar në raport mendoj se duhet të përballemi me shumë përgjegjësi për këtë sfidë pasi që në procesin e integrimit pushteti vendor është primar për nga rëndësia.

Personalisht, jam interesuar sistematikisht për mirëfunksionimin e Zyrës së Integrimit Evropian pranë Bashkisë sonë duke u bërë pjesë e gjithë iniciativave dhe aktiviteteve të

Vazhdon në Tropojë turi i takimeve të projekteve "Bashkitë për në Evropë". "Bashkitë për në Evropë", një projekt i financuar nga Bashkimi Evropian ka vazhduar serinë e takimeve të prezantimit të Raportit të Përfomancës, në Bashkinë e Tropojës.

Në takimin e moderuar nga ana e kreut të Njësisë së Integrimit Evropian në Bashkinë Tropojë, Z. Guxim Alimani, kanë qenë të pranishëm përfaqësues të pushtetit

saj.Tashmë ajo po merr formën e kërkuar dhe po kthehet në një Zyrë monitoruese për implementimin e legjislacionit të BE.

Ne jemi një Bashki e vogël por për nga territori zëmë vendin e dytë në Shqipëri. Kërkesat për investime janë të shumta sidomos në infrastruture ndaj me mundësitet tona modeste kemi përcaktuar përparësitë tona duke i shoqëruar me projekte të gatshme që kërkojnë financim ndaj dhe ngeleimi shpresëplotë se do kemi ndihmën dhe asistencën e Komisionit Evropian pasi vetë pozicioni gjeografik e bën Tropojën një nyje lidhëse mes Kosovës dhe Malit te Zi ndaj kemi ideuar dhe projekte të përbashkëta rajonale”.

Mari-Ann Roos, POlicy Officer, delegacioni i BE në Tiranë:

“Administrata lokale në Shqipëri luan një rol po aq të rëndësishëm sa administratat e tjera lokale dhe rajonale në të gjithë BE-në: si në vendet e tjera anëtarë të BE-së, në fakt, zbatimi i legjislacionit të BE-së në Shqipëri në nivelin 70% kryhet në nivelin lokal.

Qeveria Qeverisja lokale ka rolin kryesor për të siguruar përbushjen e standardeve të përcaktuara nga qeveria qendrore në sektorë të ndryshëm dhe që qytetarëve t'u ofrohet një cilësi më e mirë e shërbimeve të cilat ndikojnë pozitivisht në jetën e tyre”.

Bekim Murati, Drejtëor i Përgjithshëm i AMVV:

“Futemi në edicionin e tretë të raportit të vlerësimit të bashkive me disa rekomandime dhe gjetje. Sigurisht që rapporti është më pozitiv se sa dy paraardhësit. Dua të them se procesi i integrimit nuk është aspak i kollajtë dhe ai kërkon vërtet shumë energji dhe shumë mund nga të gjithë.

Kemi ecur shumë nga 2017-a dhe deri më sot dhe kjo ka ardhur vetëm falë angazhimit dhe mirëkuptimit të të gjitha palëve. Tashmë fokusi ynë është i gjithi në nivelin vendor. Ky është çelësi që na jep mundësinë të ballafaqohemi dhe të bëjmë të mundur që ky investim kaq i madh i BE të na kthehet në të mirë publike”.

## 08.12.2020

Gëzuar Ditën E Rinisë!

Rinia është begatia më e çmuershme e një kombi. Një komb pa një rini të shëndoshë nuk ka

prespektivë të ndritur. Rinia simbolizon lindjen e një dite të re,që çdo mëngjes ngjall shpresat e nxit buzëqeshjet për një ditë më të mirë se ajo e kaluar një ditë para.



Prioriteti im ka qënë dhe mbetet rinia.Të rinjtë janë shpresë për të tashmen dhe të ardhmen tonë!



Punësimi i të rinjëve në institucionin ku unë drejtoj është në numër të lartë sot.

Pjesëmarrja dhe numri i tyre nuk është qëllimi im i vetëm, por mjet për arritjen e ndryshimeve pozitive në jetën e të rinjëve dhe për ndërtimin e një shoqërie më të mirë. Tek unë përsosur nuk ka egzistuar aspak sindroma e militantizmit që të rinjëve tu jepet mundësia e punësimit dhe vendimarrjes, ju kam premtuar

dhe vazhdoj ta bëj do jem zëri i fortë i mbështetjes së tyre, dhe zgjidhja e të gjithe problematikave me ta, për ta dhe së bashku për komunitetin që shërbejmë.



10.12.2020



Sot kisha kënaqësinë të prisja në zyrën time Z.Tahir Gjonbalaj, veprimtarin e shquar atdhetaro-kulturor, si dhe anëtar i Këshillit Komunal të Plavë-Gucisë. Kam pasur fatin që vite më parë të takohesha me Z.Gjonbalaj, prej kohësh kryefjalë e takimeve tona ka qënë dhe mbetet rruga ndërshqiptare e ndërkombëtare që lidh Tropojën me Plavë-Gucin. Kjo rrugë ndërkufitare mundëson lidhjet farefisnore, ekonomike, kulturore e turistike të luginës së Valbonës e të Tropojës me komunat e sotme të Plavës dhe Gucisë. Projekti për investimin e Rrugës së Alpeve u mor në konsideratë dhe nga kryeministri i Shqipërisë Z.Edi Rama të cilit ia shpreha kërkesen time për realizimin e këtij projekti në vizitën e tij të fundit që bëri në Tropojë, dhe me besim të plote ju them që këtij projekti i ka ardhur momenti të kthehet në një realitet si ëndërr e kahershme e jona dhe gjithë shqiptarëve të atyre trevave.

10.12.2020

Mirënjoyje dhe vazhdueshmëri bashkëpunimi së bashku me kryetarët e fshatrave.



**TROPOJA**  
**"ERA E NDRYSHIMIT QE PERKUND TE ARDHMEN E NDRITUR TE KETIJ VENDI"**

**11.12.2020**

Në kushte të veçanta, diktuar nga pandemia covid-19, finalizuan sot, projektin "Gratë, të drejtat e tyre dhe aksesi ndaj shërbimeve".



Ky projekt bëri bashkë shumë aktorë në drejtim të fuqizimit të grave e vajzave, zhvillimit e formimit profesional të tyre, edukimit të djemve e rritjes së rolit pjesëmarrës të burrave, rritjes së kapaciteteve të ofruesve të shërbimit publik dhe po ashtu, rolin e të rinjve e aftësive të tyre si lider në komunitet.

Si pjesë e iniciativës së të rinjve Scout e Glow, u bë e mundur krijimi i një pike informacioni për turistët në Tropojë falë angazhimit të tyre, mbështetjes nga projekti, po ashtu nga Bashkia Tropojë.



dhe miqtë e mirë të Tropojës, ish vullnetarët e Korpusit të Paqes, Neda & PJ Jahangiri, të cilët punuan disa muaj për realizimin e një harte turistike. Ky projekt na tregoi se qasja pozitive mund të bëjë bashkë gjithë aktorët për të risjellë shpresë e gëzim, në komunitetin tonë.

Vlerësojmë mbështetjen e Bashkisë Tropoje, po aq sa edhe bashkëpunimin e gjithë aktorëve të përfshirë në këtë projekt.

11.12.2020



Këta mund të quhen heronjtë e jetës urbane, të cilët pak i njojin, por të gjithë kanë dëgjuar për ta,dhe në mos kanë dëgjuar gjurmët e tyre i gjejmë kudo dhe çdo ditë në të gjitha qoshet e qytetit tonë. Mirënjoyje dhe falenderime pafund për ju që zgjoheni të parët,dhe vazhdoni punën,ju që edhe në këto ditë të vështira pandemie ishit çdo dite në krye të detyrës varësisht rrezikut.

Mbështetja ime nuk ka për të munguar për ju heronjtë e përditshëm të pastërtisë dhe kujdesit ndaj ambientit.Faleminderit edhe njëherë ju që zbukuroni qytetin tonë çdo ditë.

12.12.2020



Janë këta që duan që telefonin i tyre të mos bjerë kurrë,janë ata të cilët shërbimi 24 orësh ju është bërë pjesë e rutinës.Puna e tyre më shumë mund të konsiderohet si mision sesa profesion.Zgjodha pikërisht muajin e fundit të këtij viti jo dhe shumë të lehtë për të gjithë,që të shpreh mirënjoyjen,dhe falenderimet e mia gjithësecilit që shërbeu,kontriboi dhe punoi me korrektësi.

Të jesh mirënjoyës është një element njerëzor, një virtut që padishim tropojanët e kanë patur gjithmonë dhe do e kenë edhe në të ardhmen. Nuk jam nisur asnjëherë me qëllimin që të jem inovator ose i njojur, interesimi im është ti shërbej komunitetit tim, dhe një punë e mirë fokusohet më shumë tek rezultati dhe impakti që do të kesh,si dhe bashkëpunimi i frytshem me stafin.



Mirëkuptimi, respekti, mirënjoyja dhe vlerësimi i bërë ndaj gjithkujt në këtë jetë, tingëllon më bindës kur ai shndërrohet njëkohësisht edhe në një detyrim moral, për të vijuar udhën e nisur si shërbëtor të këtij vendi dhe komuniteti të mrekullueshëm.

**TROPOJA**  
**"ERA E NDRYSHIMIT QE PERKUND TE ARDHMEN E NDRITUR TE KETIJ VENDI"**

**13.12.2020**



Sot në Stadiumin "Valbona" një foto me ekipet e Valbonës dhe Gramshit, duke inkurajuar sportistët e rinj, së bashku me homologun tim nga Gramshi.

**14.12.2020**

Me ekipin drejtues të Bashkisë Tropojë!

Faleminderit për ndihmën dhe punën tuaj të jashtëzakonshme përgjatë këtij viti!



Ne jemi me nxitim për të punuar, sepse ky komunitet ka nevojë për punë, ka nevojë për falënderime, ka nevojë çdo ditë e në çdo pjesë të tij.



Shumë punë e projekte na presin !

Ecim përpëra ! Koha ështe tani !

Na priftë e mbara !

### Nga veprimtaria e Keshillit të Bashkisë Tropoje

Këshilli bashkiak Tropoje gjatë vitit 2020 pati veprimtari intensive, duke trajtuar çeshtje të rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e komunitetit, duke respektuar figura të shquara të historisë, artit dhe kulturës së Tropojës dhe diasporës, duke manifestuar bashkëpunim të dukshëm dhe harmonizim të qendrimeve të këshilltarëve, të komisioneve përkatëse dhe kryetarit të bashkisë, por edhe dhe transparencë të vendimeve të saj ndaj publikut.

Me vkm nr. 104 dt. 28.5.2020 eshte ngritur sekretariati prane keshillit bashkiak Tropoje, Me vendim nr. 120 jane miratuar rregulloret e keshillit bashkiak.

Me vendim nr. 121 eshte miratuar plani i punes së keshillit bashkiak  
Me vendim nr. 102 eshte miratuar shtyrja e afateve te pageses se taksës nga biznese për ti ndihmuar ato për shkak te pandemisë e plot vendime të tjera të rëndësishme.



**RRUGET E REJA SI VIZION**

Vizioni kryesor i kësaj bashkie në kuptimin simbolik si prespektiva e vazhdimit kah e ardhmja evropiane janë rrugët, çdo rrugë e re për ne konsiderohet si një mundësi zhvillimi

dhe punësimi, një shikim modern për një popull që synon të kërkojë veçse sigurimin dhe garantimin e mirëqënies për veten dhe fëmijët.

Rrugët , por edhe urat, si imbol i bashkimit të pjesëve dhe komuni-tetit në ndertimin e së ardhmes!

Ky vit ka qënë i mbushur me punë në zyra për hartimin e projekteve, punë në terren nga qeveria shqiptare, Fondi i Zhvillimit Rural, donatorë të ndryshëm si dhe takimeve sensibilizuese me kryepleqtë,komunitetin e fshatrave dhe mjidiseve të ndryshme.



për zbatimin e planeve të miratuara sipas fondeve të siguruara nga qeveria shqiptare, Fondi i Zhvillimit Rural, donatorë të ndryshëm si dhe takimeve sensibilizuese me kryepleqtë,komunitetin e fshatrave dhe mjidiseve të ndryshme.





6  
**AKTIVITETE KULTURORE**



vjeç ,me këngën e mrekullueshme "Hajde dalim në Tropoje" të kënduar nga këngëtaret e talentuara .Helena Toska ,Edoma Gjidia,Insiada Bushgjoka,Klara Hasukaj nën përkujdesjen e Ilmi Hoxhës për prestatjen e këtyre talenteve .Teksti :Hamit Aliaj (Mjeshter i madh)

Në Qëndrën Kulturore të fëmijëve, në Durrës, u zhvillua Festivali i Parë Mbarëkombëtar i Këngës Populllore për Fëmijë, ku mori pjesë dhe një grup i QKF-së Tropojë, duke konkuruar me sukses dhe duke marrë vlerësimë të larta për nivelin e interpretimit

Gjithçka falë mbështetjes financiare të Bashkisë Tropojë. QKF Tropojë fiton çmimin e parë në Festivalin e I-rë mbarëkombëtar të këngës populllore për fëmijë në kategorinë e dytë , mosha 11-12 ,muzika Ibrahim Muça ,orquestracioni Bujar Doçi ,Ilmi Hoxha .Vidioklipi është realizuar mjeshtërisht nga Ismajl Buçpapaj.Kostumografija:Bukurie Lamaj .





Qëndra Kulturore e Fëmijëve organizoi kampionatin e shahut me një bashkëpunim të frytshëm me ZVA Tropojë me klubin e Shahut "Valbona", me Njësinë e Integrimit Evropian dhe me Bashkinë Tropojë.

U gërshetua bukur e natyrshëm elementi artistik me elementin sportiv. Kupën e Kampionatit per djem e fitoi Ervis Neçaj. Kupën e Kampionatit për vajza e fitoi Klea Ponari. Çmimin e dytë për djem Sajdon Çelaj. Çmimin e dytë për vajza Alba Pjeternika. Çmimin e tretë për djem Klevi Ponari. Ndjejhem krenarë se po formohet një brez elitar lojtarësh të shahut nga shkollat 9-vjeçare te rrëthit.

Në Lezhë, me 9-10 Nëntor 2020, në organizim të Ministrisë së Kulturës, u mbajt Festivali Folklorik Tipologjik i Rapsodëve dhe Instrumentistëve Popullorë ku morën pjesë shumë grupe folklorike si dhe grupi përfaqësues i Qendrës Kulturore "Dardania" Tropojë, me këngëtarë dhe instrumentistë të veglave popullore tradicionale si lahitë, sharki, fyell etj.



**TROPOJA**  
**"ERA E NDRYSHIMIT QE PERKUND TE ARDHMEN E NDRITUR TE KETIJ VENDI"**

Ndërkojë vazhdon intensivisht jetësimi i projektit në tre faza dhe përgatitjet për pjesëmarrjen e suksesshme të Ansamblit të Qendrës Kulturore "Dardania" në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës, që do të zhvillohet në vitin 2021 në Gjirokastër.



ЛЮДИ  
СТАРИЕ И МОЛОДЫЕ: ВОСПОМИНАНИЯ О ТРУДНОСТЯХ И УДОБСТВАХ









